

4YOU

magazine

www.magazineforyou.com



4You Magazine - Shqip


magazine4ushqip



• 90.2 • 96.6 •
www.radiokfor.com

Revistë mujore e KFOR-it Nr. 228 - Qershor 2026




MUSICBOX
IA DHE MUZIKA

Falas

"4You Magazine" është publikim zyrtar i KFOR-it, prodhuar dhe financiar nga KFOR-i, i shtypur në Kosovë dhe shpërndahet pa pagesë. Përmbajtja nuk reflekton qëndrimin zyrtar të koalicionit apo të shteteve anëtare. KFOR-i pranon edhe i mirëpret opinionet tuaja dhe i publikon ato, por në formë të përmbledhur. Nëse kërkohet të mos tregohet emri i autorit, kjo mund të bëhet, por nuk do të publikohen letra anonime, shpifëse apo me qëllim të keq.

Kryeredaktore:

Leonora Shabanaj Nikshiq

Gazetarë: Ali Rexha,

Violeta Matovic,

Jelena Simic Rasic

Fotografite: Ekipi "4You"

Design & Layout:

Bekim Shabani &

Leopard Cana

Stafi editorial mund të kontaktohet në telefon:

038/503-603-2139

Letrat mund të dërgohen në adresën:

HQ KFOR - Kosova Film;

"4You Magazine";

Strasbourg Building;

10000 Prishtinë

E-mail:

magazineforyou2003@gmail.com

www.magazineforyou.com



Kopertina:

1A DHE MUZIKA

Editorial

Të dashur lexues,

Vera po fillon: Një kohë për t'u rimbushur dhe për t'u rritur

Me ardhjen e qershorit vjen edhe premtimi i ditëve të gjata me diell, rutinave më të lehta dhe emocionit të pushimeve që po afrohen. Pas muajsh të tërë përkushtimi në shkollë, zgjimeve të hershme dhe orareve të ngarkuara, ky është momenti juaj i merituar për të ngadalësuar, për të marrë frymë dhe për të shijuar kënaqësitë e thjeshta të jetës. Vera nuk është thjesht një pushim, është një mundësi për t'u rilidhur me veten, me miqtë dhe me botën përreth jush.

Gjetja e qetësisë në pauzë

Ka diçka vërtet të veçantë në qetësinë që e sjell vera. Qoftë tingulli i valëve në det, qetësia e një arratie në mal apo thjesht relaksimi në shtëpi, këto momente paqeje janë thelbësore. Ato i japin mendjes suaj pushim dhe energjisë suaj rigjallërim. Në një botë që shpesh lëviz shumë shpejt, marrja e kohës për të ndalur nuk është luks, është domosdoshmëri. Le të jetë kjo verë mundësia juaj për të gjetur ekuilibrin, për t'i rimbushur mendimet dhe për të përqafuar një ritëm më të ngadaltë e më të vetëdijshëm.

Qëndroni kureshtarë, qëndroni të lidhur me dijen

Edhe pse vera është kohë relaksi, kjo nuk do

të thotë të fikni kureshtjen. Të mësuarit nuk ndodh vetëm në klasa, ai është kudo. Lexoni një libër që e keni shtyrë, eksploroni hobi të ri, shikoni dokumentarë apo provoni të mësoni një aftësi të re. Mbajta aktive e mendjes, edhe në mënyra të vogla, ju ndihmon të ktheheni në shkollë me vetëbesim dhe të gatshëm. Mendoni për këtë si një lidhje të butë me dijen, jo presion, por një zgjedhje për të vazhduar rritjen.

Momente që vlejnë

Vera është gjithashtu kohë për të krijuar kujtime, për të qeshur me miqtë, për të udhëtuar në vende të reja apo për të shijuar momentet e përditshme me familjen. Këto përvoja ju formësojnë po aq sa çdo mësim. Bëni foto, shkruani për aventurat tuaja dhe ruani këto ditë që së shpejti do të kthehen në histori që do t'i kujtoni me buzëqeshje.

Deri në takimin tonë të radhës

Ndërsa hyni në këtë stinë ngrohtësie dhe lirie, mos harroni ta shijoni çdo moment, të kujdeseni për veten dhe të qëndroni të frymëzuar. Në, nga Magazine 4You, ju urojmë një verë plot gëzim, paqe dhe zbulime. Dhe ndërsa e festojmë këtë pushim bashkë me ju, mezi e presim takimin tonë të radhës në shtator, të rifreskuar, të frymëzuar dhe gati për histori të reja së bashku.

Leonora

Indeksi



2. Editoriali, indeksi

4. Shkolla e muajit: IAAP "FEHMI AGANI"

KLINË: KU AFTËSITË TAKOJNË TREGUN E PUNËS TË SË ARDHMES

6. JO ÇDO LLOGARI ËSHTË NJË PERSON I

VËRTETË: SI PROFILET E RREME DHE 'BOTËT' E FORMËSOJNË ATË QË SHEH ONLINE

8. Life style: 5 GJËRA TË DOMOSDOSHME PËR VERËN 2026

10. Music Box: IA MUZIKORE: E ARDHMJA APO FUNDI I ARTISTËVE TË VËRTETË?

12. JO ÇDO KOMENT I ZEMËRUAR ËSHTË

REAL: SI PËRDORET GJUHA E URREJTJES PËR TË PROVOKUAR DHE KONTROLLUAR REAGIMET

14. World around us: NJË KAFSHATË - NJË MIJË HISTORI

16. Do it Yourself: SI TË BËNI NJË GJERDAN NGA GUASKAT?

18. Moviemania: GJASHTË FILMA QË DO TA DOMINOJNË VERËN TUAJ

20. Health & Sports: BOTËRORI 2026: KUSH DO TË NGRIHET ATËHERË KUR KA MË SË SHUMTI RËNDËSI?

24. Generation #: INFLUENCERËT E RREMË TË IA-së: YJET VIRTUALE QË SHESIN ILUZION

26. Your opinion about: MENDIMI JUJ PËR DESTINACIONET VERORE?

28. Wellbeing & teens: UDHËZUESI I FESTAVE TË VERËS: ARGËTIMI + MENÇURIA = KOMBINIMI MË I MIRË

30. IA PO MENDON TI APO IA?

32. Did you know? VERA

Editorial

Dear readers,

Summer begins: A time to recharge and grow

As June arrives, it brings with it the promise of long, sunny days, lighter routines, and the excitement of summer holidays just around the corner. After months of dedication to school, early mornings, and busy schedules, this is your well-deserved time to slow down, breathe, and enjoy the simple pleasures of life. Summer is not just a break, it's an opportunity to reconnect with yourself, your friends, and the world around you.

Finding peace in the pause

There is something truly special about the calm that summer offers. Whether it's the sound of waves by the sea, the quiet of a mountain escape, or simply relaxing at home, these moments of peace are essential. They allow your mind to rest and your energy to renew. In a world that often moves too fast, taking time to pause is not a luxury, it's a necessity. Let this summer be your chance to find balance, to recharge your thoughts, and to embrace a slower, more mindful rhythm.

Stay curious, stay connected to learning

While summer is a time for relaxation, it doesn't mean switching off your curiosity.

Learning doesn't only happen in classrooms, it's everywhere. Read a book you've been putting off, explore new hobbies, watch documentaries, or even try learning a new skill. Keeping your mind active, even in small ways, helps you return to school feeling confident and ready. Think of it as a gentle connection to learning, not a pressure, but a choice to keep growing.

Moments that matter

Summer is also about creating memories, laughing with friends, traveling to new places, or enjoying everyday moments with family. These experiences shape who you are just as much as any lesson. Take photos, write about your adventures, and cherish these days that will soon become stories you'll look back on with a smile.

Until we meet again

As you step into this season of warmth and freedom, remember to enjoy every moment, take care of yourself, and stay inspired. We, at 4You Magazine, wish you a summer full of joy, peace, and discovery. And as much as we celebrate this break with you, we are already looking forward to our next meeting in September, refreshed, inspired, and ready for new stories together.

Leonora

Index



25

3. Editorial, index

5. **School of the month:** IAAP "FEHMI AGANI" KLINË: WHERE SKILLS MEET THE FUTURE JOB MARKET

7. **NOT EVERY ACCOUNT IS A REAL PERSON:** HOW FAKE PROFILES AND BOTS SHAPE WHAT YOU SEE ONLINE?

9. **Life style:** 15 MUST-HAVE FOR SUMMER 2026

11. **Music Box:** MUSIC AI: THE FUTURE

OR THE END OF REAL ARTISTS?

13. **NOT EVERY ANGRY COMMENT IS REAL:** HOW HATE SPEECH IS USED TO PROVOKE AND CONTROL REACTIONS?

15. **World around us:** ONE BITE – A THOUSAND STORIES

17. **Do it Yourself:** HOW TO MAKE SHELL NECKLACE?

19. **Moviemania:** SIX FILMS THAT WILL OWN YOUR SUMMER

21. **Health & Sports:** WORLD CUP 2026: WHO WILL RISE WHEN IT MATTERS MOST?

25. **Generation #:** FAKE AI INFLUENCERS: VIRTUAL STARS THAT SELL ILLUSION

27. **Your opinion about:** YOUR OPINION ON SUMMER DESTINATIONS?

29. **Wellbeing & teens:** SUMMER PARTY GUIDE: FUN + SMART = THE BEST COMBINATION

31. **CROSSWORD PUZZLE**

4You magazine

"4You Magazine" is an official publication of KFOR, produced and financed by KFOR, printed in Kosovo and distributed freely. The contents do not necessarily reflect the official point of view of the coalition or that of any of its member states. KFOR accepts and welcomes your opinions, it will publish some of these, eventually in a condensed form. If requested the name of the writer will be withheld but no anonymous, defamatory or malicious letters will be printed.

Chief Editor:

Leonora Shabanaj Nikshiq

Journalists:

Ali Rexha,
Violeta Matovic,
Jelena Simic Rasic

Photos by:

"4You" Team

Design & Layout:

Bekim Shabani &
Leopard Cana

The editorial staff can be contacted on:

038/503-603-2139

Any letters can be sent at:

HQ KFOR - Film City;

"4You Magazine";

Strasbourg Building;

10000 Pristina

E-mail:

magazineforyou2003@gmail.com

www.magazineforyou.com



Cover:

MUSIC & AI

IAAP “FEHMI AGANI” – KLINË

KU AFTËSITË TAKOJNË TREGUN E PUNËS TË SË ARDHMES

IAAP “Fehmi Agani” në Klinë nuk është një shkollë e mesme tipike. Siç tregon edhe emri, IAAP do të thotë Instituti i Arsimit dhe Aftësisit Profesional, një shkollë e përqendruar në përgatitjen e nxënësve për jetën reale, jo vetëm për provime. Këtu, mësimi shkon përtej teorisë. Nxënësit i kalojnë tri vite duke zhvilluar aftësi praktike në fusha të ndryshme profesionale, nga instalimet elektrike të rrobaqepësia dhe zanate të tjera. Kjo qasje praktike ua jep mundësinë të hyjnë drejtpërdrejt në tregun e punës pas diplomimit, pa pasur domosdoshmërisht nevojë të vazhdojnë universitetin. Në një kohë kur shumë të rinj hasin vështirësi për të gjetur punë, ky model arsimor e ofron një avantazh të qartë, përmes trajnimeve falas që në raste të tjera mund të kushtojnë shumë dhe sërish të mos e sigurojnë të njëjtin nivel kualifikimi.



e siguron funksionimin e rregullt të aktiviteteve të përditshme. Ajo që e veçon këtë shkollë është fokusi i fortë në praktikë. Janë në dispozicion disa kabinete të specializuara, përfshirë kabinetin kompjuterik, hapësirat për instalime elektrike, rrobaqepësi dhe fusha të lidhura me shëndetësinë. Këto ambiente ua mundësojnë nxënësve të mësojnë duke punuar, gjë që është thelbësore për ndërtimin e aftësive reale.

Projekte që e formësojnë të ardhmen e nxënësve

Shkolla ka investuar gjithashtu në projekte që e përmirësojnë drejtpërdrejt cilësinë e arsimit. Siç shpjegoi Ing. Dipl. Sami Bardheci, drejtor i IAAP “Fehmi Agani” në Klinë, shumë nga këto iniciativa janë të dizajnuara për t’i përgatitur më mirë nxënësit për sfidat e jetës reale. Një nga arritjet kryesore është themelimi i Qendrës së Karrierës brenda shkollës, e pajisur me laptopë

modernë dhe tabela të mençura. Ky ambient i ndihmon nxënësit t’i eksplorojnë mundësitë profesionale dhe të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për të ardhmen e tyre. Projektet e tjera e përfshijnë instalimin e tabelave të mençura nëpër klasa dhe ndërtimin e një punëtorie për zhvillimin e praktikës profesionale në profile si instalues elektrik, automekanik dhe prodhim. Shkolla është e angazhuar edhe në aktivitete që shkojnë përtej aftësive teknike. Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, nxënësit marrin pjesë në projekte që promovojnë vlera humane, solidaritet, tolerancë dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto përvoja ndihmojnë në formimin jo vetëm të punëtorëve të aftë, por edhe të qytetarëve të përgjegjshëm.



z. Sami Bardheci - Drejtor

Një shkollë e ndërtuar për mësim praktik

Shkolla e nisi rrugëtimin e saj në vitin 2006, kur u nda nga Gjimnazi “Luigj Gurakuqi” dhe e mori emrin “Fehmi Agani”. Që atëherë, ajo është përqendruar në orientimin profesional, duke i ndihmuar nxënësit të zgjedhin drejtime që përputhen me kërkesat e tregut të punës. Objekti aktual i shkollës, i ndërtuar në vitin 2013, ofron hapësirë të mjaftueshme për zhvillimin cilësor të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Sot, shkolla i ka 637 nxënës në klasat e 10-ta, 11-ta dhe 12-ta. Një përmirësim i rëndësishëm është fakti që mësimi zhvillohet vetëm në një ndërrim, duke krijuar kushte më të mira si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit. Shkolla mbështetet nga një staf i gjerë prej 68 mësimdhënësish dhe personeli plotë që





Suksese, bashkëpunim dhe sfida

Nxënësit e IAAP “Fehmi Agani” kanë treguar tashmë rezultate të mira. Këtë vit, ata e kanë zënë vendin e parë në garat komunale të kimisë dhe gjithashtu vendin e parë në voleyboll për vajza. Këto suksese e pasqyrojnë si përkushtimin e nxënësve, ashtu edhe mbështetjen që ua ofron shkolla. Bashkëpunimi mes mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve është një tjetër faktor i rëndësishëm. Edhe pse shkolla mban komunikim të rregullt me familjet, ende ka hapësirë për përmirësim, sidomos në rritjen e pjesëmarrjes së prindërve në takime dhe aktivitete shkollore. Në të njëjtën kohë, shkolla përballet edhe me sfida. Një nga shqetësimet kryesore është braktisja e shkollës nga nxënësit, shpesh e lidhur me migrimin dhe dëshirën për të shkuar jashtë vendit. Ky mbetet një problem i ndjeshëm, pasi që shumë të rinj kërkojnë mundësi jashtë Kosovës.

Ndërtimi i të ardhmes në vend
Pavarësisht këtyre sfidave, mesazhi i drejtuesve të shkollës mbetet i qartë. Nxënësit inkurajohen të përqendrohen në mësim, të zhvillojnë aftësitë profesionale dhe të përgatiten si për tregun e punës ashtu edhe për vazhdimin e arsimit. IAAP “Fehmi Agani” tregon se arsimit nuk duhet të ndjekë vetëm një rrugë. Duke e kombinuar teorinë me praktikën, kjo shkollë u ofron nxënësve mundësi reale për të ndërtuar të ardhmen e tyre. Në një botë në ndryshim, ku aftësitë janë më të rëndësishme se kurrë, kjo qasje mund të jetë pikërisht ajo që të rinjtë kanë nevojë për të pasur sukses.

IAAP “FEHMI AGANI” – KLINË WHERE SKILLS MEET THE FUTURE JOB MARKET

IAAP “Fehmi Agani” in Klinë is not a typical high school. As its name suggests, IAAP stands for the Institute for Professional Education and Training, a school focused on preparing students for real life, not just exams. Here, learning goes beyond theory. Students spend three years developing practical skills in different professional fields, from electrical installations to tailoring and other crafts. This hands-on approach gives them the opportunity to enter the job market directly after graduation, without necessarily continuing to university. In a time when many young people struggle to find work, this model of education offers a clear advantage, providing free training that in other cases can be expensive and still not lead to the same level of qualification.

A school built for practical learning

The school began its journey in 2006, when it separated from the “Luigj Gurakuqi” Gymnasium and took the name “Fehmi Agani”. Since then, it has focused on professional orientation, helping students choose paths that match the needs of the labor market. The current school building, constructed in 2013, provides enough space for quality teaching and learning. Today, the school has 637 students across grades 10, 11, and 12. One important improvement is that classes are now held in a single shift, creating better conditions for both students and teachers. The school is supported by a large team of 68 teachers and a full staff that ensures the smooth running of daily activities. What makes the school stand-out is its strong focus on practice. Several specialized laboratories are available, including computer labs, electrical installation rooms, tailoring spaces, and health related training areas. These facilities allow students to learn by doing, which is essential for building real skills.

Projects that shape students' future

The school has also invested in projects that directly improve the quality of education. As Ing. Dipl. Sami Bardheci, Director of IAAP “Fehmi Agani” in Klinë, explained, many of these initiatives are designed to better prepare students for real world challenges. One of the key achievements is the establishment of a Career Center within the school, equipped with modern laptops and smart boards. This space helps students explore career options and develop important skills for their future. Additional projects include the installation of smart boards in classrooms and the ongoing construction of a workshop for practical training in profiles such as electrical installation, auto mechanics, and production. The school is also involved in activities that go beyond technical

skills. In cooperation with the Red Cross, students take part in projects promoting human values, solidarity, tolerance, and environmental protection. These experiences help shape not only skilled workers, but responsible members of society.

Success, cooperation, and challenges

Students from IAAP “Fehmi Agani” have already shown strong results. This year, they achieved first place in municipal level chemistry competitions and also won first place in girls’ volleyball. These successes reflect both student effort and the support provided by the school. The cooperation between teachers, students, and parents is another important factor. While the school maintains regular communication with families, there is still room for improvement, especially in encouraging more parents to actively participate in meetings and school activities. At the same time, the school faces challenges. One of the main concerns is student dropout, often linked to migration and the desire to move abroad. This remains a sensitive issue, as many young people look for opportunities outside Kosovo.

Building the future at home
Despite these challenges, the message from the school leadership remains clear. Students are encouraged to focus on learning, developing their professional skills, and preparing for both the job market and further education. IAAP “Fehmi Agani” shows that education does not have to follow only one path. By combining theory with practice, the school offers students real opportunities to build their future. In a changing world, where skills are more important than ever, this approach may be exactly what young people need to succeed.

JO ÇDO LLOGARI ËSHTË NJË PERSON I VËRTETË

Si profilet e rreme dhe 'botët' e formësojnë atë që shoh online?

Je duke e shikuar telefonin tënd. Hap një postim dhe i kontrollon komentet. Dhjetëra njerëz e pohojnë të njëjtën gjë. Disa pajtohen fuqishëm. Të tjerët e përsërisin të njëjtin mesazh me fjalë paksa të ndryshme. Duket sikur të gjithë e kanë të njëjtin mendim. Duket reale. Duket bindëse. Por, çfarë nëse shumë prej këtyre llogarive nuk iu përkasin njerëzve të vërtetë?

Çfarë janë profilet e rreme dhe 'botët'?

Jo çdo llogari online është ashtu siç duket. Disa profile krijohen për t'u dukur si përdorues realë, me emra, fotografi dhe postime. Ato janë profile të rreme, shpesh të kontrolluara nga një person ose një grup i vogël. Të tjera janë 'botë', llogari që janë plotësisht ose pjesërisht të automatizuara. Ato mund të postojnë, të komentojnë dhe të reagojnë shumë shpejt, ndonjëherë më shpejt sesa do të mundte çdo person i vërtetë. Qëllimi është i thjeshtë. Këto llogari përdoren për të shtyrë mesazhe të caktuara, për të përsëritur të njëjtat ide dhe për t'i bërë ato të duken të njohura. Kur shumë llogari e thonë të njëjtën gjë, krijohet përshtypja se "të gjithë mendojnë kështu", edhe kur kjo nuk është e vërtetë.

Pse funksionojnë ato?

Njerëzit në mënyrë natyrale i besojnë asaj që duket e përhapur. Kur shoh shumë komente që e mbështesin të njëjtën ide, ajo duket më e besueshme. Mund të

mendosh se kaq shumë njerëz nuk mund të gabojnë. Pikërisht këtë përpiqen të arrijnë profilet e rreme dhe botët. Ato nuk të bindin me argumente. Të bindin me numra, duke e bërë një mesazh të duket sikur është kudo. Kur diçka shfaqet vazhdimisht, fillon të duket normale. Fillon të duket

e vërtetë. Me kalimin e kohës, kjo mund të ndikojë në mënyrën se si njerëzit mendojnë, në atë që besojnë e madje edhe në mënyrën se si reagojnë ndaj të tjerëve. Kështu përhapet dezinformimi pa u vënë re lehtë. Nuk bëhet fjalë për një postim të vetëm të rremë, por për shumë zëra që përsërisin të njëjtin mesazh.


Si mund t'i dallosh?

Nuk ke nevojë për mjete të veçanta për të vënë re kur diçka nuk është në rregull. Disa kontrolle të thjeshta mund të të ndihmojnë të dallosh ndryshimin mes përdoruesve realë dhe llogarive të dyshimta. Fillon me profilin. A e ka një fotografi reale, apo duket shumë perfekte ose e përgjithshme? Kontrollon historikun e llogarisë. A është

krijuar së fundmi? A ka shumë pak postime ose ndjekës? Shiko komentet. A e përsërit llogaria të njëjtin mesazh në shumë postime të ndryshme? Kushtoj vëmendje mënyrës se si janë shkruar mesazhet. Llogaritë e rreme shpesh përdorin gjuhë shumë të fortë ose ekstreme. Ato rrallë tregojnë mendime të ndryshme ose të balancuara. Disa emra përdoruesish gjithashtu duken të rastësishëm ose të pazakontë, me numra dhe shkronja që nuk kanë kuptim. Një shenjë tjetër e rëndësishme është koordinimi. Nëse shumë llogari e postojnë të njëjtin koment ose mesazh në të njëjtën kohë, ky është një sinjal i fortë se diçka nuk është natyrale.

Pse ka rëndësi kjo?

Profilet e rreme dhe 'botët' nuk janë thjesht zhurmë e padëmshme në internet. Ato



mund ta formësojnë atë që njerëzit e shohin dhe besojnë. Mund ta bëjnë informacionin e rremë të duket i përhapur. Mund të krijojnë tension duke shtyrë mendime ekstreme. Gjithashtu mund t'i bëjnë njerëzit të ndiejnë presion për t'u pajtuar me diçka që në të vërtetë nuk mbështetet nga përdorues realë. Të kuptuarit e kësaj të rikthen kontrollin. Nuk ke pse ta pranosh çdo gjë që sheh si reale ose të përhapur. Mund të ndalesh një moment dhe të vësh në dyshim atë që ke përpara. Interneti është plot me njerëz të vërtetë që ndajnë ide reale. Mirëpo, është gjithashtu plot me llogari të krijuara për të ndikuar te ti. Të dish dallimin është ajo që të bën një përdorues të zgjuar. Para se t'i besosh asaj që "të gjithë po e thonë", bëji vetes një pyetje të thjeshtë: **A po e thonë vërtetë të gjithë, apo janë vetëm disa zëra të përsëritur shumë herë?**



DALLO LLOGARINË E RREME

Para se të besosh ose të reagosh, hidh një sy të shpejtë:

- Kontrolllo kur është krijuar llogaria
- Shiko numrin e postimeve dhe ndjekësve
- Shiko nëse i njëjti mesazh përsëritet shpesh
- Ki kujdes me profilet që përdorin gjuhë ekstreme
- Nëse shumë llogari postojnë të njëjtën gjë në të njëjtën kohë, tregohu i kujdesshëm

JO ÇDO GJË ONLINE ËSHTË ASHTU SIÇ DUKET. QËNDRO I VËMENDSHËM, QËNDRO NË KONTROLL.



NOT EVERY ACCOUNT IS A REAL PERSON

How fake profiles and bots shape what you see online?

You are scrolling through your phone. You open a post and check the comments. Dozens of people are saying the same thing. Some agree strongly. Others repeat the same message in slightly different words. It feels like everyone has the same opinion. It feels real. It feels convincing. But what if many of those accounts do not belong to real people?

What are fake profiles and bots?

Not every account online is what it looks like. Some profiles are created to look like real users, with names, photos, and posts. These are fake profiles, often controlled by one person or a small group. Others are bots, accounts that are fully or partly automated. They can post, comment, and react very quickly, sometimes faster than any real person could. The goal is simple. These accounts are used to push certain messages, repeat the same ideas, and make them look popular. When many accounts say the same thing, it creates the impression that "everyone thinks this way", even when that is not true.

Why do they work?

People naturally trust what looks popular. When you see many comments supporting the same idea, it feels more believable. You might think that so many people cannot be wrong. This is exactly what fake profiles and bots try to achieve. They do not convince you with arguments. They convince you with numbers, making a message feel like it is everywhere. When something appears again and again, it starts to feel normal. It starts to feel true. Over time, this can influence how people think, what they believe, and even how they react to others. This is how disinformation spreads without being obvious. It is not one fake post, but many voices repeating the same message.

How can you spot them?

You do not need special tools to notice when something is not right. A few simple checks can help you see the difference between real users and suspicious accounts. Start with the profile. Does it have a real photo, or does it look too perfect or generic? Check the account history. Was it created recently? Does it have very few posts or followers? Look at the comments. Does the account repeat the same message under many different posts? Pay attention to the way messages are

written. Fake accounts often use very strong or extreme language. They rarely show different opinions or balanced views. Some usernames also look random or unusual, with numbers and letters that do not make sense. Another important sign is coordination. If many accounts post the same comment or message at the same time, it is a strong signal that something is not natural.

Why does this matter?

Fake profiles and bots are not just harmless internet noise. They can shape what people see and believe. They can make false information look popular. They can create tension by pushing extreme opinions. They can also make people feel pressure to agree with something that is not actually supported by real users. Understanding this puts you back in control. You do not have to accept everything you see as real or popular. You can take a step back and question what is in front of you. The internet is full of real people sharing real ideas. But it is also full of accounts designed to influence you. Knowing the difference is what makes you a smart user. Before you trust what "everyone is saying", ask yourself one simple question: **Is it really everyone, or just a few voices repeated many times?**

SPOT THE FAKE ACCOUNT!

Before you trust or react, take a quick look:

- Check when the account was created
- Look at the number of posts and followers
- See if the same message is repeated often
- Be careful with profiles that use extreme language
- If many accounts post the same thing at the same time, be cautious

NOT EVERYTHING ONLINE IS WHAT IT SEEMS. STAY AWARE, STAY IN CONTROL.

5 GJËRA TË DOMOSDOSHME PËR VERËN 2026



Ja na erdhi muaji qershor dhe bashkë me të edhe ndjesia se gjithçka sapo ka filluar. Pushimet verore janë përpara jush, plot dy muaj liri, netë të vona, plane spontane dhe aventura të vogla që do të mbahen mend shumë më gjatë se vetë vera. Pavarësisht nëse qëndroni në qytet apo planifikoni të udhëtoni, kjo është periudha kur rutina e përditshme ia lë vendin pushimit dhe kënaqësisë, sipas ritmit dhe dëshirave tuaja. Kjo është arsyeja pse, në vend të listave të rrëmuishme, është e rëndësishme të keni disa gjëra që do ta bëjnë këtë verë më të thjeshtë, më të organizuar dhe mbi të gjitha më të relaksuar.

1. Syzet dielli cilësore

Vera dhe syzet e domosdoshme. Syzet e diellit janë më shumë sesa një aksesori mode, ato janë, do të pajtoheshin edhe ju, një domosdoshmëri e përditshme gjatë verës. Një palë syze të mira me mbrojtje nga rrezet UV e mbrojnë shikimin tuaj, ndërsa gjithashtu e përmirësojnë çdo veshje pa shumë mendim. Një model universal mund të rregullojë stilin tuaj për të gjithë verën.

2. Torbë ose çantë shpine funksionale

Ditët e verës rrallë shkojnë sipas planit, kështu që mund të kaloni lehtësisht nga detyrat e mëngjesit tek kafeja e pasdites ose dalja në mbrëmje. Prandaj është e rëndësishme të keni një torbë ose çantë shpine që mund të përballojë një ritëm të tillë. Ndoshta madhësia mesatare është ideale, keni hapësirë të mjaftueshme për gjërat thelbësore si uji, syzet, karikuesi ose rrobat e holla, por ende praktike për t'u mbajtur gjatë gjithë ditës. Dizajni i thjeshtë dhe ngjyrat neutrale e bëjnë edhe më të lehtë për t'u kombinuar.

3. Libër ose përmbajtje për kohën kur jeni „offline“

Pavarësisht se jemi vazhdimisht në telefonat tanë, vera është koha ideale

për të ngadalësuar dhe për të bërë një pushim nga ekrani. Qoftë një libër i mirë, një ditar, apo edhe një fletore për të shënuar mendimet tuaja, momente të tilla e bëjnë diferencën. Nuk është fjala që të "zhdukeni" tërësisht nga rrjetet, por t'i japësh vetes hapësirë për të pushuar në një mënyrë krejtësisht të ndryshme. Leximi në diell, në hijen e një parku ose gjatë një udhëtimi e ka një ritëm të veçantë, më të ngadaltë, më të relaksuar por më të singertë. Në fund të fundit, janë ato momentet e vogla

kur nuk je „online“ që shpesh mbeten pjesa më e mirë e verës.

4. Playlist-a për verë

Megjithatë, çdo verë e ka kolonën zanore të vetë. Pavarësisht nëse po shkoni në një udhëtim, po ecni apo thjesht po relaksoheni, muzika e mirë e ndryshon gjithë atmosferën. Pra, krijoni një listë këngësh (playlist) në njërin nga platformat e transmetimit (streaming), e cila do t'ju shoqërojë gjatë gjithë verës, sepse më vonë ato këngë do t'ju rikthejnë në këto momente.



5 MUST-HAVE FOR SUMMER 2026



5. SPF si pjesë e një rutine të detyrueshme

Mbrojtja nga dielli është diçka që nuk duhet anashkaluar. Një krem i mirë me SPF e mbron lëkurën dhe ju lejon të kaloni kohë jashtë pa shqetësime. Nuk është gjëja më argëtuese në listë, por sigurisht që është më e rëndësishmja për shëndetin tuaj.

Në fund të fundit, vera nuk ka pse të jetë e përsosur për të qenë e mirë. Mjafton të kesh gjërat e duhura me vete dhe pak hapësirë për spontanitet e pjesa tjetër do të vijë vetë. Nuk ke nevojë të përmbushësh çdo "listë vere" për të pasur një verë të mirë. Ndonjëherë momentet më të mira janë ato që as nuk i ke planifikuar, mund të jetë një takim i rastësishëm, një udhëtim i paplanifikuar ose një ditë kur nuk ke bërë asgjë dhe megjithatë ka qenë e përsosur. Kjo është arsyeja pse ju sugjerojmë të kënaqeni më shumë, të ndiqni ritmin tuaj dhe lejoni që vera juaj të jetë pikërisht ashtu siç ju përshtatet më së miri.



June is here, bringing with it that familiar feeling that everything is just beginning. The summer holidays are ahead of you, two whole months of freedom, late evenings, spontaneous plans and small adventures that stay with you far longer than the season itself. Whether you're staying in the city or planning to travel, this is the time when everyday routines give way to rest and enjoyment, shaped entirely by your own rhythm and wishes. That's exactly why, instead of long, overwhelming lists, it's enough to have just a few essentials that will make this summer simpler, more organised and, above all, more relaxing.

1. A pair of quality sunglasses

Summer and sunglasses are a must-have. Sunglasses are more than a fashion accessory, they are, you will agree, an everyday essential during the summer. A good pair with proper UV protection keeps your eyes safe while effortlessly lifting any outfit without much thought. One versatile model can sort out your style for the entire summer.

2. A functional bag or backpack

Summer days rarely go according to plan, and it's easy to move from morning errands to an afternoon coffee or an evening out. That's why it's important to have a bag or backpack that can keep up with that pace. A medium size is often ideal, spacious enough for the essentials like water, sunglasses, a charger or a light layer, yet still practical to carry throughout the entire day. A simple design and neutral colours make it even easier to pair with anything.

3. A book or offline content

No matter how attached we are to our phones, summer is the perfect moment to slow down a little and take a break from screens. Whether it's a good book, a magazine or even a notebook for jotting down your thoughts, these small pauses make a real difference. It's not about disappearing from social media entirely, it's about giving yourself space to rest in a different way. Reading in the sun, in the shade of a park or while travelling has its own rhythm, slower, calmer, but somehow

more honest. In the end, those little offline moments often become the most memorable parts of summer.

4. A summer playlist

Still, every summer has its own soundtrack. Whether you're travelling, taking long walks or simply relaxing, the right music can change the whole atmosphere. That's why it's worth creating a playlist on your favourite streaming platform, one that will follow you throughout the season, because later it's exactly those songs that will bring you back to these moments.

5. SPF as a non-negotiable part of your routine

Sun protection is something you really shouldn't skip. A good SPF keeps your skin safe and lets you enjoy your time outdoors without worry. It may not be the most exciting item on the list, but it's certainly the most important one for your health.

After all, summer doesn't need to be perfect to be good. All you truly need are the right things by your side and a little room for spontaneity, the rest will fall into place naturally. You don't have to tick off every "summer list" to have a good summer. Sometimes the best moments are the ones you never planned at all, a last-minute night out, an unexpected trip or a day when you did absolutely nothing, yet it still felt perfect. That's why we suggest you enjoy more, follow your own rhythm and let your summer be exactly the way that suits you best.

IA DHE MUZIKA

e ardhmja apo fundi i artistëve të vërtetë?

E dëgjon një këngë që tingëllon saktësisht si Drake apo The Weeknd. Zëri është perfekt, stili duket real dhe produksioni është i pastër. Pastaj zbulon diçka befasuese. Artisti nuk e ka regjistruar kurrë atë këngë. Kënga është krijuar me ndihmën e inteligjencës artificiale (IA). Ajo që dikur dukej si fantashkencë, sot është pjesë e përditshme e muzikës dhe ky trend nuk po ndodh vetëm në botë. Ai po bëhet gradualisht pjesë edhe e rajonit tonë.

Kur muzika merr një jetë të dytë

Një nga pjesët më interesante të IA në muzikë është mënyra se si ajo i rikthen këngët e vjetra në jetë. Këngët klasike me të cilat shumë njerëz janë rritur, po rizbulohen në mënyra krejtësisht të reja. IA mund të marrë një këngë të vjetër dhe ta shndërrojë në një version modern, ndonjëherë me elemente jazz apo soul, ose me një ritëm të freskët që përshtatet me playlistat e sotme. Për dëgjuesit e rinj, kjo do të thotë të zbulojnë muzikë që ndoshta nuk do ta kishin dëgjuar kurrë më parë. Një këngë që dikur i përkiste një brezi tjetër, papritur ndihet e re dhe aktuale. Platformat e rrjeteve sociale si TikTok luajnë një rol të madh në këtë proces, ku video të shkurtra me versione të ripunuara mund të bëhen virale shumë shpejt. Në këtë mënyrë, IA nuk po krijon vetëm muzikë, por po ndihmon edhe në ruajtjen dhe rikthimin e kulturës.

Kur IA bëhet artist

IA nuk është më vetëm një mjet që ndihmon në krijimin e 'coverave' të këngëve ekzistuese. Në disa raste, ajo po bëhet vetë artisti. Projekte si Bora Feira tregojnë sa larg mund të shkojë kjo ide. Nuk bëhet fjalë thjesht për kopjim zërash apo remiks këngësh. Bëhet fjalë për krijimin e një identiteti të plotë, me muzikë origjinale, një stil të dallueshëm dhe një audiencë në rritje. Bora Feira është ndër pionieret e hershme të

artistëve të IA me një personalitet të qartë, dhe ajo që e bën edhe më interesante është se ajo paraqitet si një artiste shqiptare me këngë origjinale si "Jam e lirë". Kjo nuk lidhet më vetëm me teknologjinë, por me identitetin. Mund të dëgjosh këngët e saj, t'i pëlqesh dhe madje t'i shtosh në 'playlist' pa menduar dy herë se kush qëndron pas tyre. Por në momentin që e kupton se artisti nuk është njeri, përvoja ndryshon. A do ta dëgjoje njësoj? A mund të lidheni me diçka që nuk e ka një histori të vërtetë, apo personi, ose në këtë rast njerëzit që qëndrojnë pas muzikës, ende kanë rëndësi?

Sfida për artistët e vërtetë

Sado emocionuese të tingëllojë kjo, ajo sjell edhe sfida serioze. Disa artistë pretendojnë se mjetet e IA-së janë trajnuar duke e përdorur punën e tyre pa leje. Kjo ka çuar tashmë në debate dhe procese ligjore në industrinë e muzikës. Pyetjet mbi pronësinë, originalitetin dhe

drejtësinë po bëhen më të rëndësishme se kurrë. Në të njëjtën kohë, IA e bën krijimin e muzikës më të lehtë se kurrë më parë. Dikush pa asnjë trajnim muzikor mund të krijojë një këngë që tingëllon profesionale. Kjo i ndryshon rregullat e lojës. Nëse kushdo mund të krijojë një hit, çfarë ndodh me ata që kanë kaluar vite duke i përsosur aftësitë e tyre? Për disa, kjo ndihet si një kërcënim. Për të tjerë, është thjesht një fazë e re në evoluimin e muzikës, e ngjashme me ardhjen e produksionit digjital apo platformave të transmetimit.



MUSIC & AI

the future or the end of real artists?

You are listening to a song that sounds exactly like Drake or The Weeknd. The voice is perfect, the style feels real, and the production is clean. But then you find out something surprising. The artist never recorded it. The song was created using artificial intelligence. What once sounded like science fiction is now part of everyday music and this trend is not only happening around the world. It is slowly becoming part of our region too.



E ardhmja apo diçka tjetër? Pra, ku na çon e gjithë kjo? A është IA-ja e ardhmja e muzikës, apo fillimi i diçkaje që mund t'i zëvendësojë artistët e vërtetë? Ende nuk ka një përgjigje të thjeshtë. Ajo që është e qartë është se muzika po bëhet më e hapur dhe më e qasshme. Zëra të rinj, si njerëzorë ashtu edhe artificialë, po hyjnë në skenë. Kreativiteti nuk kufizohet më vetëm nga aftësitë teknike. Në të njëjtën kohë, vlera e shprehjes njerëzore, emocioneve dhe përvojës mund të bëhet edhe më e rëndësishme. Dëgjuesit mund të fillojnë të pyesin jo vetëm se si tingëllon një këngë, por edhe kush qëndron pas saj dhe pse është krijuar. Çfarëdo që të sjellë e ardhmja, një gjë është e sigurt. Po jetojmë në një moment ndryshimi. Muzika po evoluon më shpejt se kurrë më parë dhe idetë e reja po e formësojnë mënyrën se si ajo krijohet dhe shpërndahet. Qoftë njerëzorë apo IA, tingulli i së nesërme tashmë është këtu dhe sapo ka filluar.

When music gets a second life

One of the most exciting parts of AI in music is how it brings old songs back to life. Classic tracks that many people grew up with are now being rediscovered in completely new ways. AI can take an older song and transform it into a modern version, sometimes with jazz or soul elements, or with a fresh beat that fits today's playlists. For young listeners, this means discovering music they might never have heard before. A song that once belonged to another generation suddenly feels new and relevant again. Social media platforms like TikTok play a big role in this, where short clips of remade songs can quickly go viral. In this way, AI is not just creating music, it is helping to preserve and reintroduce culture.

When AI becomes the artist

But AI is no longer just a tool helping do existing song covers. In some cases, it is becoming the artist itself. Projects like Bora Feira show how far this idea can go. This is not simply about copying voices or remixing songs. It is about creating a full identity, with original music, a recognizable style, and a growing audience. Bora Feira is among the early pioneers of AI artists with a clear personality, and what makes it even more interesting is that she is presented as an Albanian artist with original songs like "Jam e lirë". This is not just about technology anymore, it is about identity. You might listen to her songs, enjoy them, and even add them to your playlist without thinking twice about who is behind them. But once you realize the artist is not human, it changes the experience. Would you still listen the same way? Can you connect with something that has no real story, or does the person, or in this case the people behind the music, still matter?

The challenge for real artists

As exciting as this sounds, it also brings serious challenges. Some artists argue that AI tools are trained using their work without permission. This has already led to debates and legal actions in the music industry. Questions about ownership, originality, and fairness are becoming more important than ever. At the same time, AI makes music creation easier than before. Someone with no musical training can now generate a song that sounds professional. This changes the rules of the game. If anyone can create a hit, what happens to those who spent years learning their craft? For some, this feels like a threat. For others, it is simply a new phase in the evolution of music, similar to the introduction of digital production or streaming platforms.

The future or something else? So where does this leave us? Is AI the future of music, or is it the beginning of something that could replace real artists? There is no simple answer yet. What is clear is that music is becoming more open and more accessible. New voices, both human and artificial, are entering the scene. Creativity is no longer limited by technical skills alone. At the same time, the value of human expression, emotion, and experience may become even more important. Listeners might start to ask not only how a song sounds, but also who is behind it and why it was created. Whatever the future holds, one thing is certain. We are living in a moment of change. Music is evolving faster than ever, and new ideas are shaping the way it is created and shared. Whether it is human or AI, the sound of tomorrow is already here, and it is only getting started.

JO ÇDO KOMENT I ZEMËRUAR ËSHTË REAL

Si përdoret gjuha e urrejtjes për të provokuar dhe kontrolluar reagimet?

E hap një postim dhe fillon të lexosh komentet. Disa njerëz po e diskutojnë temën. Të tjerët jo. Disa komente bien në sy. Janë agresive, fyese dhe të shkruara për të tërhequr vëmendje. Shumë shpejt, toni ndryshon. Më shumë njerëz përfshihen. Diskutimi kthehet në debat. Emocionet rriten. Duket intensive dhe reale. Por, mbaje mend, disa prej këtyre komenteve nuk janë shkruar për të ndarë një mendim, por për të nxitur një reagim.

Gjuha e urrejtjes është më shumë se “vetëm një mendim”

Është e lehtë të mendosh se gjuha e urrejtjes vjen vetëm nga njerëz të zemëruar ose të frustruar. Ndonjëherë kjo është e vërtetë. Por, jo gjithmonë. Në shumë raste, komentet fyese shkruhen me qëllim për të nxitur emocione të forta. Qëllimi nuk është të zhvillohet një diskutim. Qëllimi është të bëhen njerëzit të reagojnë. Këto komente janë krijuar për të prekur nervat, për të fyer dhe për të krijuar konflikt. Kur njerëzit reagojnë me zemërim, mesazhi përhapet më tej. Disa komente nuk janë as për t'u marrë seriozisht. Ato shkruhen në një mënyrë që garanton reagim. Sa më të forta fjalët, aq më i fortë reagimi. Kjo e krijon një cikël ku vëmendja bëhet më e rëndësishme sesa e vërteta apo respekti.

Pse funksionon provokimi?

Platformat online janë ndërtuar rreth ndërveprimit. Sa më shumë reagojnë njerëzit, aq më i dukshëm bëhet një postim. Përgjigjet e zemëruara, debatet dhe komentet e përsëritura e shtojnë



përmbajtjen më lart, duke e bërë më të lehtë që të tjerët ta shohin. Kjo do të thotë se gjuha e urrejtjes mund të përhapet shpejt, jo sepse është e drejtë, por sepse tërheq vëmendje. Çdo reagim, edhe kur nuk pajtohesh, mund të ndihmojë që mesazhi të arrijë te më shumë njerëz. Disa përdorues e kuptojnë këtë shumë mirë. Ata postojnë komente ekstreme ose fyese sepse e dinë se do të shkaktojnë reagime. Sa më i fortë reagimi, aq më i suksesshëm bëhet postimi. Në shumë raste, njerëzit që shkruajnë komente të tilla nuk janë të interesuar të ndryshojnë mendime. Ata janë të interesuar t'i kontrollojnë bisedat. Duke krijuar konflikt, ata i mbajnë të tjerët të angazhuar dhe i bëjnë të reagojnë.

Si mund ta dallosh?

Nuk ke nevojë të jesh ekspert për të vënë re kur një koment po përpigjet të të provokojë. Ka disa shenja të qarta. Gjuha është shpesh ekstreme dhe emocionale. Ka pak ose aspak përpjekje për të shpjeguar një këndvështrim. I njëjti lloj mesazhi mund të shfaqet vazhdimisht. Personi nuk duket i interesuar për diskutim. Në vend të kësaj, ai përsërit fyerje ose përpigjet të nisë debate. Mund të vësh re gjithashtu se këto komente shfaqen shumë shpejt pas publikimit të një postimi. Në disa raste, ato shfaqen në numër të madh dhe e ndjekin një model të ngjashëm. Kjo është një shenjë tjetër se qëllimi nuk është diskutim, por reagim.


Çfarë mund të bësh?

Hapi më i rëndësishëm është i thjeshtë. Mos reago menjëherë. Nuk ke pse t'i përgjigjesh çdo koment. Nuk ke pse të provosh se dikush është gabim në çdo situatë. Ndonjëherë, përgjigja më e fortë është të mos përgjigjesh fare. Kur zgjedh të mos përfshihesh, ndalon së ndihmuari përhapjen e mesazhit. Qëndron në kontroll





të reagimit tënd, në vend që dikush tjetër ta kontrollojë atë. Në disa situata, është më mirë të raportosh përmbajtjen e dëmshme sesa t'i përgjigjesh asaj. Kjo ndihmon në uljen e dukshmërisë së saj pa i dhënë më shumë vëmendje. Në fund të fundit, jo çdo koment me gjuhë urrejtjeje e meriton kohën tënde. Disa nuk kërkojnë përgjigje. Ato kërkojnë reagime.



KUR TË NDALOSH SË ANGAZHUARI

Bëj një hap pas nëse:

- *Komenti është vetëm fytes, jo diskutues*
- *I njëjti mesazh përsëritet vazhdimisht*
- *Qëllimi duket të jetë provokimi i zemërimit*
- *Nuk ka përpjekje reale për komunikim*
- *Në vend që të reagosh, raportoje*

JO ÇDO KOMENT KA NEVOJË PËR PËRGJIGJE. QËNDRIMI I QETË ËSHTË ZGJEDHJE.



NOT EVERY ANGRY COMMENT IS REAL

How hate speech is used to provoke and control reactions?

You open a post and start reading the comments. Some people are discussing the topic. Others are not. A few comments stand out. They are aggressive, insulting, and written to get attention. Very quickly, the tone changes. More people join in. The discussion turns into an argument. Emotions rise. It feels intense and real. Remember though, some of those comments are not meant to share an opinion at all, but to trigger a reaction.

Hate speech is more than "just an opinion"

It is easy to think that hate speech comes only from people who are angry or frustrated. Sometimes that is true. But not always. In many cases, hateful comments are written on purpose to trigger strong emotions. The goal is not to have a discussion. The goal is to make people react. These comments are designed to push buttons, to offend, and to create conflict. When people respond with anger, the message spreads further. Some comments are not even meant to be taken seriously. They are written in a way that guarantees a reaction. The stronger the words, the stronger the response. This creates a cycle where attention becomes more important than truth or respect.

Why does provoking you work?

Online platforms are built around interaction. The more people react, the more visible a post becomes. Angry replies, arguments, and repeated comments push content higher, making it easier for others to see. This means that hate speech can grow quickly, not because it is right, but because it gets attention. Every reaction, even when you disagree, can help the message reach more people. Some users understand this very well. They post extreme or offensive comments because they know it will trigger reactions. The stronger the reaction, the more successful the post becomes. In many cases, people who post such comments are not interested in changing opinions. They are interested in controlling conversations. By creating conflict, they keep others engaged and make them react.

How to recognize it?

You do not need to be an expert to notice when a comment is trying to provoke you. There are a few clear signs. The language is often extreme

and emotional. There is little or no attempt to explain a point of view. The same type of message may appear again and again. The person does not seem interested in discussion. Instead, they repeat insults or try to start arguments. You may also notice that these comments appear very quickly after a post is published. In some cases, they appear in large numbers and follow a similar pattern. This is another sign that the goal is not discussion, but reaction.

What can you do?

The most important step is simple. Do not react immediately. You do not have to reply to every comment. You do not have to prove someone is wrong in every situation. Sometimes, the strongest response is no response. When you choose not to engage, you are preventing the message spread. You stay in control of your reaction, instead of letting someone else control it. In some situations, it is better to report harmful content instead of responding to it. This helps reduce its visibility without giving it more attention. After all, not every hateful comment deserves your time. Some are not looking for answers. They are looking for reactions.

WHEN TO STOP ENGAGING?

Take a step back if:

- *The comment is only insulting, not discussing*
- *The same message is repeated again and again*
- *The goal seems to be provoking anger*
- *There is no real attempt to communicate*
- *Instead of reacting, report it*

NOT EVERY COMMENT NEEDS A RESPONSE. STAYING CALM IS A CHOICE.

NJË KAFSHATË - NJË MIJË HISTORI

Imagjinoni të udhëtoni nëpër botë, por pa biletë aeroplani. Mjafton të bëni vetëm një hap drejt tezgës më të afërt të ushqimit. Ushqimi në rrugë nuk është thjesht ushqim i shpejtë; është një kulturë, një stil jetese dhe një mënyrë për t'i njohur njerëzit përmes shijeve të tyre. Nga rrugët e zhurmshme të Tajlandës deri te lagjet shumëngjyreshe të Parisit, çdo kafshatë mbart një histori tradite, zakonesh dhe kreativiteti, gjersa ne po ua paraqesim ato në këtë artikull.



Ushqimi i rrugës është i shpejtë, i përbalueshëm dhe më e rëndësishmja është argëtues. Pa rregulla, pa formalitete. Hani ku të doni, si të doni dhe me kë të doni. Për brezin tuaj, është gjithashtu një mënyrë shprehjeje. Fotot e ushqimit, shijet e reja dhe kombinimet e pazakonta bëhen shpejt përmbajtje virale. Por pas të gjitha këtyre fshihet diçka më e rëndësishme, të qenit të hapur ndaj botës. Kur provoni një pjatë nga një kulturë tjetër, në të vërtetë njiheni me njerëzit, zakonet dhe mënyrën e tyre të jetesës. Ushqimi në rrugë ju mëson të jeni kureshtarë, të guximshëm dhe të gatshëm të provoni diçka të re.

ITALIA - e thjeshtë, por perfekte

Ushqimi italian i rrugës është provë se nuk keni nevojë të keni një recetë të ndërlikuar për të shijuar një shije të shkëlqyer. Pica al taglio shitet me copë dhe hahet ndërsa ecni në rrugët e Romës, ndërsa arancini janë kombinimi perfekt i një kore krokante dhe një mbushjeje të butë me djathë ose mish. Çdo gjë është e thjeshtë, por e bazuar në përbërës cilësorë e mu kjo është arsyeja pse është kaq e mirë.

GJERMANIA - ngopëse dhe konkrete

Nëse ju pëlqen ushqimi i fortë dhe konkret, atëherë do t'ju pëlqejë ushqimi gjerman i rrugës. "Currywurst" është një hit i vërtetë, një salcicë e mbuluar me keçup dhe kërri (curry), zakonisht e shoqëruar me patate të skuqura. Mandej e kemi edhe "bratwurst", një klasik i grillit që mund ta gjeni në çdo hap. Ky është një ushqim që ngrohë dhe ngopë, ideal për ditë më të ftohta.

GREQIA - atmosferë mesdhetare në çdo kafshatë

Ushqimi grek i rrugës sjell ekuilibrin perfekt midis mishit dhe përbërësve të freskët. "Gyros" është i preferuari i të gjithëve, një byrek i mbushur me mish, patate të skuqura dhe salcë "tzatziki". "Souvlaki" është një version më i thjeshtë i mishit të prerë në hell, por po aq i përsosur. Gjithçka është e lehtë, por e shijshme dhe perfekte për ditët e verës në det.

FRANCA - ushqim rruge me stil

Francezët madje e shndërrojnë ushqimin e rrugës në një ritual të vogël. Krepat janë përfundim të holla, të domosdoshme që mund t'i hani të ëmbla ose të kripura. Përveç kësaj, një sanduiç me baguetë është një vakt i shpejtë, por cilësor. Gjithçka duket e thjeshtë, por e ka një prekje elegancie tipike për Francën.

MEKSIKA - një shpërthim shijesh

Meksika është një parajsë për dashamirësit e erëzave dhe shijeve të forta. Takot janë të vogla, por të fuqishme - tortilje të mbushura me mish, perime dhe salca të ndryshme. "Elote" është diçka krejtësisht e ndryshme, misër me djathë, majonezë dhe erëza. Çdo kafshatë është intensive dhe plot energji.

TAJLANDA - shpejtësi dhe aromë

Ushqimi tajlandez i rrugës është një shfaqje e vërtetë. "Pad thai" përgatitet para jush brenda pak minutash, i shoqëruar nga tingujt e tiganëve dhe aroma e erëzave. Kombinimi i shijes së ëmbël, të kripur dhe pikante e bën atë të veçantë. Për ëmbëlsirë, mango me oriz ngjitet është diçka që duhet ta provoni të paktën një herë në jetën tuaj.





TURQIA - një bashkim kulturash në një pjatë

Turqia është vendi ku takohen Evropa dhe Azia e kjo reflektohet në ushqim. "Doner kebab" është një nga specialitetet më të famshme të ushqimit të rrugës në botë, mish i lëngshëm në një simit me perime dhe salca. Simiti është një zgjedhje e thjeshtë por e shijshme për mëngjes ose meze të lehtë. Megjithatë, nuk keni pse të udhëtoni larg për të përjetuar këtë aventurë. Edhe në qytetin tuaj me siguri ka një stendë ose një dyqan të vogël që ofron diçka të ndryshme. Pra, herën tjetër që dilni me miqtë, anashkaloni opsionet standarde dhe kërkoni diçka të re. Mund të zbuloni një shije që do t'ju kënaqë, ose edhe t'ju frymëzojë të bëni versionin tuaj të pjatës suaj të preferuar të ushqimit të rrugës. Sepse e vërteta është e thjeshtë: bota është plot me shije dhe mënyra më e mirë për ta njohur atë është kafshatë pas kafshatë!

TRENDET QË PO E PUSHTOJNË GJENERATËN Z

Sot, ushqimi i rrugës po përjeton një epokë të re. Të rinjtë në të gjithë botën po i kombinojnë recetat tradicionale me ide moderne. Kështu krijohen pjatat "fusion", për shembull, një hamburger me erëza aziatike ose taco me përbërës ballkanikë. Rrjetet sociale e kanë një ndikim të madh në popullaritetin e ushqimit të rrugës. Një video virale mund ta bëjë një pjatë një hit global brenda natës. "Instagram" dhe "TikTok" janë plot me ushqime shumëngjyrëshe, të pazakonta dhe "Instagramore" që e tërheqin vëmendjen e brezit tuaj.

Një tjetër trend i rëndësishëm është versioni më i shëndetshëm i ushqimit të rrugës, kështu që gjithnjë e më shumë tezga ofrojnë vakte vegane, vegjetariane dhe të përgatitura në mënyrë organike, gjë që tregon se ushqimi i rrugës mund të jetë një zgjedhje e shijshme dhe e përgjegjshme.

ONE BITE - A THOUSAND STORIES

Imagine traveling the world without a plane ticket. All it takes is a single step to the nearest food stand. Street food isn't just fast food; it's culture, a way of life, and a way to get to know people through their tastes. From the busy streets of Thailand to the colourful neighbourhoods of Paris, every bite carries a story about tradition, habits, and creativity - and in this article, we bring those stories closer to you.

Street food is quick, affordable, and, most importantly, fun. There are no rules, no formalities. You eat where you want, how you want, and with whomever you want. For your generation, it's also a form of self-expression. Photos of food, new flavours, and unusual combinations quickly go viral. But behind all that lies something more important - openness to the world. When you try a dish from another culture, you're actually getting to know people, their habits, and their way of life. Street food teaches you to be curious, bold, and ready to try something new.

ITALY - simple, yet perfect

Italian street food proves that you don't need a complicated recipe to achieve top-quality flavour. Pizza al taglio is sold by the slice and eaten while walking through the streets of Rome, while arancini offer the perfect combination of a crispy coating and a soft filling of cheese or meat. Everything is simple, but based on quality ingredients - and that's exactly why it tastes so good.

GERMANY - hearty and substantial

If you enjoy strong, filling food, German street food will suit you. Currywurst is a true hit, a sausage topped with ketchup and curry sauce, usually served with fries. There's also bratwurst, a grilled classic you can find everywhere. This is food that warms you up and satisfies your hunger, ideal for colder days.

GREECE - a Mediterranean vibe in every bite

Greek street food offers the perfect balance between meat and fresh ingredients. Gyros is everyone's favourite, a pita filled with meat, fries, and tzatziki sauce. Souvlaki is a simpler version, skewered meat, but just as perfect. Everything is light, incredibly tasty, and suited to warm seaside days.

FRANCE - street food with style

The French turn even street food into a small ritual. Crêpes are a must, thin pancakes you can enjoy sweet or savoury. Alongside them, a baguette sandwich is a quick yet high-quality meal. Everything looks simple, but carries a touch of elegance typical of France.

MEXICO - an explosion of flavour

Mexico is a paradise for lovers of spices and bold tastes. Tacos may be small, but they're powerful-tortillas filled with meat, vegetables, and a variety of sauces. Elote

is something completely different, a corn topped with cheese, mayonnaise, and spices. Every bite is intense and full of energy.

THAILAND - speed and aroma

Thai street food is a true performance. Pad Thai is prepared right in front of you in just minutes, accompanied by the sounds of the pan and the aromas of spices. The blend of sweet, salty, and spicy flavours makes it unique. For dessert, mango with sticky rice is something you should try at least once in your life.

TÜRKIYE - cultures meeting on a plate

Türkiye is where Europe and Asia meet, and that's reflected in its food. Döner kebab is one of the most famous street food specialties in the world, juicy meat in flatbread with vegetables and sauces. Simit is a simple but tasty choice for breakfast or a snack. Still, you don't have to travel far to experience this kind of adventure. Even in your city, there's surely a stand or small shop offering something different. So next time you go out with friends, skip the usual options and look for something new. You might discover a flavour that amazes you, or even inspires you to create your own version of a favourite street food dish. Because the truth is simple: the world is full of flavours, and the best way to explore it is one bite on the go.

TRENDS THAT ARE WINNING OVER GENERATION Z

Today, street food is entering a new era. Young people around the world are combining traditional recipes with modern ideas. This is how "fusion" dishes are created-for example, a burger with Asian spices or tacos with Balkan ingredients. Social media plays a huge role in the popularity of street food. A single viral video can turn a dish into a global hit overnight. Instagram and TikTok are full of colourful, unusual, and "Instagrammable" bites that capture the attention of your generation.

Another important trend is the rise of healthier street food options. More and more stands now offer vegan, vegetarian, and organically prepared meals, showing that street food can be both a tasty and a responsible choice.



DO IT YOURSELF



SI TË BËNI NJË GJERDAN NGA GUASKAT?

Nëse po kaloni kohë në det këtë verë, ka shumë mundësi që të keni mbledhur të paktën disa guaska të bukura, ato që i morët "si suvenir" dhe tani janë diku të lëna mënjanë. Pse të mos i shndërroni në diçka që mund ta bartni çdo ditë? Bërja e një gjerdani me guaska është një mënyrë e lehtë dhe krijuese për të ruajtur një pjesë vere dhe për t'a shndërruar atë në një detaj personal.

Materiali i nevojshëm

- tel i hollë ose lloj litari për bizhuteri
- rruaza të vogla
- guaska ose elementë dekorativë
- kapëse (ose një e rregullueshme)
- unaza lidhëse
- pincë (për të punuar me tel)
- gërshërë



Gjerdanët e frymëzuar nga deti kombinojnë guaska, rruaza dhe tekstura natyrale, duke u dhënë atyre një pamje të relaksuar dhe verore. Prandaj, lexoni më poshtë se si të bëni një gjerdan me guaska.

Udhëzimet hap pas hapi


1



Hapi 1: Përgatitja e bazës

Para se të filloni t'a bëni, është e rëndësishme të matni saktë bazën e gjerdanit. Pavarësisht nëse përdorni tel apo litar, rregulloni gjatësinë që t'i përshatet qafës suaj, por lini disa centimetra shtesë për lidhjen ose vendosjen e një kapëseje.

2



Hapi 2: Vendosja e detajit qendror

Elementi qendror si një guaskë ose një zbukurim më i madh i jep karakter të gjithë gjerdanit. Vendoseni atë afërsisht në mes të bazës dhe sigurojeni me kujdes. Nëse përdorni tel, mund t'a kaloni atë përmes hapjes në guaskë dhe ta lakoni pak për t'a mbajtur të qëndrueshme. Tek litari, është e rëndësishme t'a mbani njëntë të shtërnguar, por jo shumë të ngushtë në mënyrë që materiali të mbetet fleksibël.


3



Hapi 3: Shtimi i rruazave

Pasi të keni siguruar pjesën qendrore, filloni të shtoni rruazat. Mund të zgjidhni një renditje të thjeshtë e simetrike ose të kombinoni madhësi dhe ngjyra të ndryshme për një efekt më interesant. Shtojini ato gradualisht në të dyja anët për t'a bërë gjerdanin të duket i barabartë.

4



Hapi 4: Përfundimi dhe mbyllja e gjerdanit

Kur të keni mbaruar së lidhuri, duhet t'a mbyllni gjerdanin siç duhet. Nëse përdorni një kapëse, fiksuar atë në të dyja skajet dhe kontrolloni që hapet dhe mbyllet lehtë. Nëse po e bëni një version të rregullueshëm, atëherë bëni një nyjë që mund të lirohet ose ngushtohet sipas nevojës. Tek teli, lakoni dhe siguroni skajet në mënyrë që të mos jenë të mprehta dhe të mos ju pengojnë gjatë bartjes.

5



Hapi 5: Detajet përfundimtare

Në fund, kontrolloni që gjithçka është e fiksuar mirë dhe që gjerdani të rrëzë mirë në qafë. Nëse është e nevojshme, rregullojeni më tej ose shkurtojeni. Tani që e keni mbaruar, do të keni një gjerdan unik që jo vetëm duket bukur, por është një mënyrë e lehtë për të shprehur stilin dhe kreativitetin tuaj. Mund t'i bëni ata në variacione të ndryshme dhe t'i kombinoni me bizhuteri të tjera ose t'i dhuroni si një shenjë e vogël kujdesi për të dashurit.

Shpresojmë që ju pëlqeu ky propozim! Nëse keni një ide krijuese, na shkruani në: magazineforyou2003@gmail.com dhe ndani përvojën tuaj me ne.

DO IT YOURSELF



HOW TO MAKE SHELL NECKLACE?

If you're spending time at the seaside this summer, there's a good chance you've already collected a few beautiful shells, the kind you bring home "as a souvenir" and then leave sitting somewhere to the side. So why not turn them into something you can wear every day? Making a shell necklace is an easy and creative way to preserve a piece of summer and turn it into a personal accessory.


Required materials

- Thin jewellery wire or string
- Small beads
- Shells or decorative elements
- Clip (or an adjustable knot)
- Jump rings
- Pliers (for working with wire)
- Scissors

Sea inspired necklaces combine shells, beads and natural textures, giving them a relaxed, summery look. Below, you can read how to make your own shell necklace.

Step-by-step instruction


1



Step 1: Preparing the base

Before you begin, it's important to measure the base of your necklace correctly. Whether you're using wire or jewellery cord, adjust the length to fit your neck, but leave a few extra centimetres for tying or attaching the clasp.

2



Step 2: Adding the central element

The central piece, such as a shell or a larger decorative charm, gives the necklace its character. Position it roughly in the middle of the base and secure it carefully. If you're using wire, you can thread it through the hole in the shell and gently bend it to keep it stable. If you're working with cord, make sure the knot is tight enough to hold the element in place, but not overly tightened so the material stays flexible.


3



Step 3: Adding the beads

Once the central piece is secured, start adding the beads. You can choose a simple, symmetrical arrangement or mix different sizes and colours for a more interesting effect. Add them gradually on both sides to keep the necklace looking balanced.


4



Step 4: Securing and closing the necklace

When you finish stringing the beads, you need to close the necklace properly. If you're using a clip, attach it to both ends and check that it opens and closes easily. If you're making an adjustable version, tie a firm knot that can be loosened or tightened as needed. For wire, bend and secure the ends so they are not sharp and won't cause discomfort while wearing the necklace.

5



Step 5: Final touches

Finally, check that everything is securely fastened and that the necklace sits nicely around your neck. Adjust or trim it if necessary. Once you're done, you'll have a unique necklace that not only looks beautiful but also offers a simple way to express your style and creativity. You can make different variations, combine them with other jewellery pieces, or give them as a small, thoughtful gift to someone special.

We hope you enjoyed this idea! If you also have a creative suggestion of your own, write to us at: magazineforyou2003@gmail.com and share your experience with us.



GJASHTË FILMA QË DO TA DOMINOJNË VERËN TUAJ

Vera sjell ditë më të gjata, më shumë kohë të lirë dhe arsye perfekte për t'u zhytur në histori të reja. Nga aventura epike dhe rikthime superheronjsh, te personazhe nostalgjikë dhe të preferuarit e publikut, kjo përzgjedhje bashkon disa nga filmat më të shumëpritur të sezonit. Pavarësisht nëse kërkon aksion, emocione apo diçka krejtësisht ndryshe, këta filma ofrojnë diçka që ia vlen të shikohet.



THE LEGEND OF AANG: THE LAST AIRBENDER

Zhanri: Animacion / Aventurë

Aktorët: Eric Nam, Dave Bautista, Dionne Quan, Román Zaragoza

Pse duhet ta shikoni:

Ky kapitull i ri e rikthen botën e Avatarit, duke u fokusuar te Aang dhe miqtë e tij në vitet e tyre më të vona. Duke u mbështetur në suksesin e serisë origjinale, filmi eksploron një fazë të re të rrugëtimit të tyre duke qëndruar besnik ndaj asaj që e bëri kaq të dashur për publikun. Ai ofron si për fansat ashtu edhe për shikuesit e rinj mundësinë për të përjetuar një histori të njohur nga një këndvështrim i freskët dhe më i pjekur.

MASTERS OF THE UNIVERSE

Zhanri: Aksion / Fantazi

Aktorët: Nicholas Galitzine, Jared Leto,



Camila Mendes, Idris Elba

Pse duhet ta shikoni:

Pas shumë vitesh larg, Princi Adam rikthehet në një botë që ka ndryshuar plotësisht. Përballë sundimit të Skeletorit, ai duhet të pranojë fatin e tij si He-Man dhe të luftojë për të rikthyer ekuilibrin. Me një kombinim nostalgjie dhe tregimi modern, ky film e rikthen një univers klasik duke e prezantuar atë për një gjeneratë të re.

SUPERGIRL

Zhanri: Aksion / Superhero

Aktorët: Milly Alcock, Jason Momoa, Matthias Schoenaerts, David Krumholtz

Pse duhet ta shikoni:

E dërguar në Tokë për t'u rritur nga kushëriri i saj Superman, Kara Zor-El duhet të gjejë vendin e saj duke e balancuar identitetin dhe fuqinë. Kjo histori e sjell një perspektivë ndryshe në botën e superheronjve, duke u fokusuar jo vetëm në aksion, por edhe në karakter dhe identitet, duke ofruar një qasje të freskët ndaj një prej figurave më të njohura të DC.

THE ODYSSEY

Zhanri: Aksion / Epik

Aktorët: Tom Holland, Matt Damon, Anne Hathaway, Robert Pattinson

Pse duhet ta shikoni:

Një nga historitë më të vjetra dhe më të famshme në botë rikthehet me një vizion të ri. I drejtuar nga Christopher Nolan dhe i xhiruar me teknologjinë IMAX, ky film epik e ndjek rrugëtimin e Odiseut për t'u kthyer në shtëpi pas Luftës së Trojës. Me një kast të fuqishëm dhe prodhim në shkallë të gjerë, ai kombinon



tregimin klasik me një përvojë moderne kinematografike.

SPIDER-MAN: BRAND NEW DAY

Zhanri: Aksion / Superhero

Aktorët: Tom Holland, Zendaya, Jon Bernthal, Mark Ruffalo

Pse duhet ta shikoni:

Katër vite pas ngjarjeve të No Way Home, Peter Parker përballlet me një realitet krejtësisht të ri. Duke jetuar i vetëm dhe i harruar nga ata që dikur i donte, ai e përqafon plotësisht rolin e tij si Spider-Man. Ky kapitull i ri e eksploron një hero më të pjekur dhe të izoluar, ndërsa një kërcënim i ri dhe i fuqishëm fillon të shfaqet, duke e shtyrë atë më tej se kurrë më parë.



SIX FILMS THAT WILL OWN YOUR SUMMER

Summer brings longer days, more free time, and the perfect excuse to dive into new stories. From epic adventures and superhero returns to nostalgic characters and fan favorites, this selection brings together some of the most anticipated releases of the season. Whether you are looking for action, emotion, or something completely different, these films offer something worth watching.



COYOTE VS. ACME

Zhanri: Komedi / Familjar

Aktorët: John Cena, Will Forte, Lana Condor, P.J. Byrne

Pse duhet ta shikoni:

Pas viteve të përpjekjeve të dështuara për të kapur Road Runner-in, Wile E. Coyote zgjedh një qasje krejtësisht tjetër. Këtë herë, beteja zhvendoset në sallën e gjyqit, ku ai e sfidon kompaninë përgjegjëse për të gjitha shpikjet e dështuara. Një kthesë kreative për një personazh klasik, kjo histori i jep më në fund mundësinë këtij të nënvlerësuar të ngrihet dhe të dëgjohet.



Nga rikthimet e mëdha të interpretimet e reja, kjo verë e sjell një përzgjedhje filmash që dallohen në mënyra të ndryshme. Pavarësisht nëse kërkon aksion, nostalgji apo diçka të papritur, këta filma pritet ta bëjnë sezonin të paharrueshëm.

THE LEGEND OF AANG: THE LAST AIRBENDER

Genre: Animation / Adventure

Cast: Eric Nam, Dave Bautista, Dionne Quan, Román Zaragoza

Why you should watch it:

This new chapter revisits the world of Avatar, focusing on Aang and his friends in their later years. Building on the success of the original series, the film explores a new stage of their journey while staying true to what made it so popular. It offers both fans and new viewers a chance to experience a familiar story from a fresh and more mature perspective.

MASTERS OF THE UNIVERSE

Genre: Action / Fantasy

Cast: Nicholas Galitzine, Jared Leto, Camila Mendes, Idris Elba

Why you should watch it:

After years away, Prince Adam returns to a world that has changed completely. Facing the rule of Skeletor, he must embrace his destiny as He-Man and fight to restore balance. With a mix of nostalgia and modern storytelling, this film brings back a classic universe while introducing it to a new generation.

SUPERGIRL

Genre: Action / Superhero

Cast: Milly Alcock, Jason Momoa, Matthias Schoenaerts, David Krumholtz

Why you should watch it:

Sent to Earth to be raised by her cousin Superman, Kara Zor-El must find her place while balancing identity and power. This story brings a different perspective to the world of superheroes, focusing not only on action, but also on character and identity, offering a fresh look at one of DC's most recognizable heroes.

THE ODYSSEY

Genre: Action / Epic

Cast: Tom Holland, Matt Damon, Anne Hathaway, Robert Pattinson

Why you should watch it:

One of the oldest and most famous stories in the world returns with a new vision. Directed by Christopher Nolan and filmed using IMAX technology, this epic follows Odysseus on his long journey home after the Trojan War. With a powerful cast and large-scale production, it combines classic storytelling with a modern cinematic experience.

SPIDER-MAN: BRAND NEW DAY

Genre: Action / Superhero

Cast: Tom Holland, Zendaya, Jon Bernthal, Mark Ruffalo

Why you should watch it:

Four years after the events of No Way Home, Peter Parker faces a completely new reality. Living alone and forgotten by those he once loved, he fully embraces his role as Spider-Man. This new chapter explores a more mature and isolated hero, while a powerful new threat begins to rise, pushing him further than ever before.

COYOTE VS. ACME

Genre: Comedy / Family

Cast: John Cena, Will Forte, Lana Condor, P.J. Byrne

Why you should watch it:

After years of failed attempts to catch the Road Runner, Wile E. Coyote takes a completely different approach. This time, the fight moves to the courtroom as he challenges the company behind all his failed inventions. A creative twist on a classic character, the story finally gives the underdog a chance to stand up and be heard.

From returning legends to new interpretations, this summer's lineup offers a strong mix of stories that stand out in different ways. Whether you are looking for action, nostalgia, or something unexpected, these films are set to make the season unforgettable.

BOTËRORI 2026

Kush do të ngrihet atëherë kur ka më së shumti rëndësi?



Për disa kombëtare, rruga drejt FIFA World Cup 2026 vazhdon të jetë e mbushur me shpresë dhe mundësi. Për të tjera, ëndrra mund të duket tepër afër, por njëkohësisht jashtëzakonisht e paarritshme. Fushatat kualifikuese gjithmonë sjellin emocione, besim, presion dhe momente që tifozët i kujtojnë për vite me radhë. Disa skuadra ngrihen pikërisht në momentin e duhur, ndërsa të tjera mbeten duke menduar se çfarë mund të kishte ndodhur. Megjithatë, pavarësisht se si përfundon rrugëtimi për ekipet individuale, emocionet rreth Kampionatit Botëror nuk zhduken kurrë. Sapo turneu fillon, futbollit edhe një herë bëhet qendra e vëmendjes në mbarë planetin.

Momenti i Anglisë apo një tjetër zhgënjim?

Të gjithë sytë këtë herë mund të jenë te Anglia. Për vite me radhë, ajo ka pasur talent, emra të mëdhenj dhe pritje të jashtëzakonshme, por gjithmonë dukej sikur diçka mungonte. Gjenerata e Steven Gerrard dhe Frank Lampard ishte pranë suksesit, por nuk arriti kurrë të fitonte një trofe madhor. Kohët e fundit, Anglia arriti finale dhe gjysmëfinale të rëndësishme, por hapi i fundit drejt lavdisë vazhdoi t'i shpëtonte. Tani një grup i ri, i udhëhequr nga lojtarë si Jude Bellingham, mbart

të njëjtën shpresë me një energji ndryshe. Skuadra duket më e balancuar, më e sigurt dhe e gatshme për të kontrolluar ndeshjet e mëdha. Anglia nuk mbështetet më vetëm te tradita apo reputacioni. Tashmë duket si një ekip me pjekuri, disiplinë taktike dhe lojtarë që çdo javë përballen me presionin në nivelin më të lartë të futbollit. Megjithatë, pyetja mbetet e njëjtë. A mundet kjo Angli ta shndërrojë më në fund premtimin në lavdi? Apo presioni i pritjeve do të bëhet sërish





tepër i rëndë? Pikërisht kjo pasiguri e bën Anglinë një nga skuadrat më interesante për t'u ndjekur gjatë turneut.

Yjet gati për të marrë kontrollin

Franca mbetet një nga skuadrat më të kompletuara në futbollin botëror. Me lojtarë si Kylian Mbappé në krye, ajo e kombinon shpejtësinë, përvojën dhe vetëbesimin në skenën më të madhe. Francezët dinë si të fitojnë dhe kjo përvojë shpesh bëhet diferenca në momentet vendimtare. Edhe kur nuk luajnë futbollin e tyre më të mirë, ata gjithmonë duken të aftë për të gjetur zgjidhje. Spanja, nga ana tjetër, sjell një valë të re energjie. Pas suksesit në Kampionatin e fundit Evropian, yjet e reja si Lamine Yamal dhe Nico Williams tashmë kanë treguar se mund të ngrihen atëherë kur ka më së shumti rëndësi. Stili i tyre pa frikë dhe mentaliteti sulmues i bëjnë një nga skuadrat më emocionuese të kompeticionit. Ajo që e bën Spanjën veçanërisht të rrezikshme është vetëbesimi. Lojtarët e rinj shpesh hyjnë në turne pa frikë. Ata ndikohen më pak nga historia, kritikë apo presioni i jashtëm. Pikërisht kjo liri mund t'i bëjë të paparashikueshëm dhe jashtëzakonisht të vështirë për t'u ndalur. Nëse vazhdojnë me të njëjtin ritëm, Spanja mund të bëhet një nga historitë më të mëdha të këtij Botërori. Portugalia është një tjetër skuadër që nuk mund të injorohet. Edhe pse Cristiano Ronaldo po afrohet drejt viteve të fundit të karrierës së tij legjendare, kombëtarja përrthetij duket më e fortë dhe më e balancuar se më parë. Lojtarët si Vitinha, Bruno Fernandes, Rafael Leão, Bernardo Silva

WORLD CUP 2026

Who will rise when it matters most?

For some nations, the road to the FIFA World Cup 2026 is still filled with hope and possibility. For others, the dream may already feel painfully close yet frustratingly out of reach. Qualification campaigns always bring emotion, belief, pressure, and moments that supporters remember for years. Some teams rise at the perfect moment, while others are left wondering what could have been. Yet no matter how the journey ends for individual teams, the excitement surrounding the World Cup never disappears. Once the tournament begins, football once again becomes the center of attention across the planet.

England's moment or another heartbreak?

All eyes this time may be on England. For years, they have had talent, famous names, and huge expectations, yet something always seemed missing. The generation of Steven Gerrard and Frank Lampard came close but never delivered a major title. More recently, England reached important finals and semifinals, but the final step toward glory still escaped them. Now a new group, led by players like Jude Bellingham, carries the same hope with a different energy. The squad looks balanced, confident, and ready to take control of big matches. England no longer depends only on tradition or reputation. They now look like a team with maturity, tactical discipline, and players who already perform under pressure every week at the highest club level. The question still feels familiar, however. Can this England team finally turn promise into glory? Or will the pressure of expectation once again become too heavy? That uncertainty alone makes them one of the most fascinating teams to follow during the tournament.

Stars ready to take over

France remains one of the most complete teams in world football. With players like Kylian Mbappé leading the way, they combine speed, experience, and confidence on the biggest stage. They know how to win, and that experience often becomes the difference in crucial moments. Even when France are not playing their best football, they always seem capable of finding solutions. Spain, on the other hand, bring a fresh wave of energy. After their success at the last European Championship, young stars like Lamine Yamal and Nico Williams have already shown they can rise when it matters most. Their fearless style and attacking mindset make them one of the most exciting teams in the competition. What makes Spain especially dangerous is their confidence. Young players often enter tournaments without fear. They

are less affected by history, criticism, or outside pressure. That freedom can make them unpredictable and extremely difficult to stop. If their momentum continues to grow, Spain could become one of the biggest stories of the World Cup. Portugal is another team impossible to ignore. Even as Cristiano Ronaldo approaches the final years of his legendary career, the national team around him looks stronger and more balanced than before. Players such as Vitinha, Bruno Fernandes, Rafael Leão, Bernardo Silva, and João Neves give Portugal creativity, energy, and technical quality across the pitch. They are no longer a team built around only one superstar. They now look capable of competing against anyone through collective strength as well. These are the players and teams who can define a tournament, not only with skill, but with confidence under pressure.

Giants with something to prove

Argentina and Brazil will always be part of the conversation. They are the foundation of beautiful football, nations that have shaped the game with talent and passion for decades. Their history alone demands respect, and their shirts carry weight no matter the generation. Argentina arrives as defending world champions, but that creates its own pressure. Every opponent wants to defeat the champion. Every performance is judged more harshly. The challenge is no longer reaching the top but staying there. Even with enormous quality, repeating success at the World Cup remains one of the hardest achievements in sport. Brazil, meanwhile, continue searching for the dominance that once defined them. Their supporters expect attractive football, trophies, and unforgettable moments. Anything less always feels disappointing in a country where football is treated almost like a religion. Yet this generation still has enormous talent and enough creativity to explode at any moment. At the same time,

dhe João Neves i japin Portugalisë kreativitet, energji dhe cilësi teknike në të gjithë fushën. Ata nuk janë më një ekip i ndërtuar vetëm rreth një superylli. Tani duken të aftë të rivalizojnë me këdo përmes forcës kolektive. Këta janë lojtarët dhe skuadrat që mund ta përcaktojnë një turne, jo vetëm me aftësi, por edhe me vetëbesim nën presion.

Gjigantët që kanë diçka për të dëshmuar

Argjentina dhe Brazili gjithmonë do të jenë pjesë e diskutimit. Ata janë themeli i futbollit të bukur, kombe që e kanë formësuar lojën me talent dhe pasion për dekada me radhë. Vetëm historia e tyre kërkon respekt dhe fanellat e tyre kanë peshë në çdo gjeneratë. Argjentina vjen si kampione në fuqi e botës, por kjo e krijon presionin e vet. Çdo kundërshtar dëshiron ta mposhtë kampionin. Çdo paraqitje gjykohet më ashpër. Sfidat nuk është më të arrish majën, por të qëndrosh aty. Edhe me cilësi të jashtëzakonshme, përsëritja e suksesit në Kampionatin Botëror mbetet një nga arritjet më të vështira në sport. Ndërkohë, Brazili vazhdon të kërkojë dominimin që dikur e përcaktonte. Tifozët e tyre presin futboll të bukur, trofe dhe momente të paharrueshme. Çdo gjë më pak se kaq gjithmonë duket zhgënjyese në një vend ku futbollit trajtohet pothuajse si fe. Megjithatë, kjo gjeneratë ende ka talent të jashtëzakonshëm dhe



mjaftueshëm kreativitet për të shpërthyer në çdo moment. Në të njëjtën kohë, po rritet ndjesia se futbollit ndërkombëtar po bëhet më i balancuar. Hendeku mes gjigantëve tradicionalë dhe skuadrave në zhvillim nuk duket më aq i madh sa më parë. Kombëtalet më të vogla po përmirësohen taktikisht, fizikisht dhe mendërisht. Kjo

do të thotë se edhe ekipet më të mëdha nuk mund të mbështeten më vetëm te reputacioni. Kjo i bën Argjentinën dhe Brazilin po aq të rrezikshëm, por edhe më të paparashikueshëm. Në një turne si ky, paparashikueshmëria mund të jetë po aq e fuqishme sa dominimi.

Skuadrat që mund t'i befasojnë të gjithë

Pastaj vijnë skuadrat që mund t'i befasojnë të gjithë. Norvegjia spikat si "dark horse" kryesor. Me lojtarë ofensivë si Erling Haaland, Martin Ødegaard dhe Alexander Sørloth, ata e kanë fuqinë sulmuese që mund të ndryshojë çdo ndeshje. Në një ditë të mirë, ata mund të shënojnë kundër kujtdo dhe edhe nëse pësojnë gol, gjithmonë duken të aftë të shënojnë më shumë. Ata luajnë me liri, vetëbesim dhe bindjen se mund t'i sfidojnë emrat më

të mëdhenj. Për shumë tifozë neutralë, Norvegjia mund të bëhet një nga skuadrat më argëtuese për t'u parë, sepse futbollit i qasen në mënyrë agresive dhe pa frikë. Uruguai vjen menjëherë pas tyre. Me historinë, intensitetin dhe shpirtin garues që e kanë, ata kurrë nuk duken si një kundërshtar i lehtë, pavarësisht skenës ku luajnë. Ata udhëhiqen nga Federico Valverde, lojtari që vrapon pa u lodhur nga njëra anë e fushës në tjetrën dhe një nga mesfushorët më të kompletuar në botë, një lider i vërtetë që e vendos ritmin e skuadrës si në sulm ashtu edhe në mbrojtje. Skuadra si Maroku, Kroacia apo edhe Shtetet e Bashkuara mund t'iu shkaktojnë probleme favoritëve tradicionalë. Turnetë e fundit kanë treguar se organizimi, disiplina dhe besimi ndonjëherë mund të triumfojnë ndaj emrave më të mëdhenj dhe lojtarëve më të famshëm. Sapo momenti



fillon të ndërtohet brenda një Botërori, vetëbesimi mund ta shndërrojë një 'outsajder' në një pretendent të vërtetë.

Kundërshtari i padukshëm

Përtej lojtarëve dhe skuadrave, ekziston edhe një sfidë tjetër që i pret. Ky Kampionat Botëror do të shtrihet në tri shtete, me distanca të gjata udhëtimi, klima të ndryshme dhe orare të ngarkuara. Ndeshjet do të zhvillohen në vapë vere, me lagështi, stuhi dhe ndërprerje të mundshme që mund të ndikojnë ritmin e turneut. Pauzat për hidratim, rikuperimi dhe përqendrimi mendor do të bëhen po aq të rëndësishme sa taktikat dhe talenti. Skuadrat nuk do të duhet vetëm të fitojnë ndeshje, por edhe të menaxhojnë trupin, nivelin e energjisë dhe përqendrimin gjatë javëve të konkurrencës intensive. Vetë distancat e udhëimit mund të ndikojnë në performancë. Trajnerët dhe ekipet mjekësore mund të bëhen po aq të rëndësishëm sa yjet e skuadrave kur bëhet fjalë për ruajtjen e freskisë fizike gjatë turneut. Në shumë mënyra, vetë kushtet mund të bëhen kundërshtari i padukshëm.

Një skenë e re për heronj të rinj
Kjo është ajo që e bën këtë edicion kaq special. Nuk bëhet fjalë vetëm për atë se kush ka lojtarët më të mirë, por për atë se kush mund të përballojë gjithçka që vjen me të. Presionin, pritjet, udhëtimin, motin dhe vetë momentin. Diku mes gjithë kësaj, heronj të rinj do të lindin, ashtu siç ndodh gjithmonë. Pikërisht këto momente e bëjnë Kampionatin Botëror të paharrueshëm. Sepse në fund të fundit, Botërori është më shumë sesa një garë. Është një nga festat më të mëdha sportive në planet, një kremtim global i futbollit që bashkon kombe, kultura dhe miliona tifozë.



there is a growing feeling that international football is becoming more balanced. The gap between traditional giants and emerging teams no longer feels as large as before. Smaller football nations are improving tactically, physically, and mentally. That means even the biggest teams can no longer rely only on reputation. That makes Argentina and Brazil just as dangerous, but also more unpredictable. In a tournament like this, unpredictability can be just as powerful as dominance.

The teams that can surprise everyone

Then come the teams that could surprise everyone. Norway stands out as the number one dark horse. With attacking players like Erling Haaland, Martin Ødegaard, and Alexander Sørloth, they have the kind of firepower that can change any match. On a good day, they can score against anyone, and even if they concede, they always look capable of scoring more. They play with freedom, confidence, and belief that they can challenge bigger names. For many neutral fans, Norway may become one of the most entertaining teams to watch because they approach football aggressively and without fear. Uruguay follows closely behind. With their history, intensity, and competitive spirit, they are a team that never feels like an easy opponent, no matter the stage. They are led by Federico Valverde, the never tiring end line to end line runner and one of the world's most complete players, a true leader and inspirer who sets the rhythm for his team in both attack and defense. Teams like Morocco, Croatia, and even the United States could also create problems for the traditional favorites. Recent tournaments have shown that organization, discipline, and belief can sometimes overcome bigger names and more famous players. Once momentum

starts building inside a World Cup, confidence can transform an outsider into a genuine contender.

The invisible opponent

Beyond the players and teams, there is another challenge waiting. This World Cup will stretch across three countries, with long travel distances, changing climates, and demanding schedules. Matches will be played in summer heat, with humidity, storms, and possible interruptions shaping the rhythm of the tournament. Hydration breaks, recovery, and mental focus will become as important as tactics and talent. Teams will not only have to win matches, but they will also have to manage their bodies, energy levels, and concentration over weeks of intense competition. Travelling distances alone may affect performance. Coaches and medical teams may become just as important as star players when it comes to maintaining physical freshness throughout the competition. In many ways, the conditions themselves may become the invisible opponent.


A new stage for new heroes

That is what makes this edition so special. It is not just about who has the best players, but who can handle everything that comes with it. Pressure, expectation, travel, weather, and the moment itself. Somewhere in all of this, new heroes will emerge, just as they always do. These moments are what make the World Cup unforgettable. Because in the end, the World Cup is more than a competition. It is one of the biggest sporting fiestas on the planet, a global celebration of football that brings together nations, cultures, and millions of fans.

INFLUENCERËT E RREMË TË IA-së: YJET VIRTUALE QË SHESIN ILUZION

Kur profili nuk është i vërtetë, por ndikimi po, mirë se vini në epokën e mashtrimeve digjitale

Në një botë ku rrjetet sociale formësojnë trendet, stilin e jetesës dhe madje edhe vendimet tona për blerje, është shfaqur një lloj i ri "yjesh", influencerët e krijuar nga inteligjenca artificiale. Në shikim të parë, ata duken të përsosur: gjithmonë të buzëqeshur, me pamje të patëmetë dhe me postime të kuruara me kujdes. Por, pas këtyre profileve shpesh nuk qëndron një person i vërtetë, por një algoritëm. Problemi lind kur kjo vijë fshihet dhe publiku nuk e kupton se ka të bëjë me një iluzion.



Influencerët e IA-së nuk janë domosdoshmërisht diçka e keqe. Disa prej tyre janë të shënuar qartë si personazhe virtuale dhe përdoren në marketing si mjete kreative. Por gjithnjë e më shpesh po shfaqen profile që paraqiten si persona realë, pa asnjë paralajmërim se janë gjeneruar nga inteligjenca artificiale. Përkishtë këtu fillon problemi. Një nga format më të zakonshme të mashtrimit janë rekomandimet e rreme të produkteve. Influenceri i IA-së "teston" kozmetikë, veshje ose suplemente dhe jep komente entuziaste. Ndjekësit besojnë, blejnë, ndërsa produkti shpesh nuk i përmbush përshkrimet, ose nuk ekziston fare. Në disa raste, linqet çojnë në faqe të rreme që mbledhin të dhëna ose para pa e dërguar produktin.

Dashuri, besim dhe mashtrim

Edhe më i rrezikshëm është trendi i manipulimeve emocionale. Ka raste kur pro-

filet e krijuara nga IA hyjnë në komunikim të drejtpërdrejtë me ndjekësit, duke e ndërtuar një marrëdhënie besimi. Porositë janë të personalizuar, të ngrohta, ndonjëherë edhe romantike. Njerëzit, pa e ditur se po bisedojnë me një algoritëm, e zhvillojnë ndjenjën e afërsisë. Në disa raste, kjo ka çuar në mashtrime financiare. "Influenceri" kërkon ndihmë, për një sëmundje të supozuar, një udhëtim apo një investim. Ndjekësit dërgojnë para, dhe më pas profili zhduket. Këto lloj mashtrimesh i prekin veçanërisht përdoruesit më të rinj dhe ata që kërkojnë vëmendje ose mbështetje në rrjetet sociale.

Identiteti i rrejshëm dhe vjedhje e pamjes (fytirës)


Një nga format më shqetësuese të keqpërdorimit të IA-së është përdorimi i fotografive reale të njerëzve, të cilat më pas modifikohen dhe shndërrohen

në një "person të ri". Këto profile duken autentike sepse përdorin elemente reale, por në thelb janë të rreme. Në vend të shprehjeve të huaja, këtu mund të flasim për "video dhe imazhe të rreme" që e imitojnë besnikërisht pamjen dhe të folurën e dikujt. Janë të njohura edhe rastet kur identitetet e figurave publike janë keqpërdorur përmes këtyre materialeve të rreme. "Fytirat" e tyre kanë promovuar investime të dyshimta, kriptovaluta apo edhe produkte mjekësore. Njerëzit kanë besuar sepse e kanë "parë" një fytyrë të njohur, por porositë nuk kanë qenë të tyre.

Kur IA shkruan - dhe mashtron


Keqpërdorimi i inteligjencës artificiale nuk përfundon te rrjetet sociale. Po shfaqen gjithnjë e më shumë shembuj të ashtuquajturve "shkrimtarë të IA-së" që publikojnë libra në internet. Në platformat e botimit të pavarur po dalin qindra tituj të krijuar plotësisht nga IA, por që paraqiten si vepra të autorëve të vërtetë.

Problemi lind kur këto libra shiten si materiale profesionale ose edukative, për shembull, udhëzues për shëndetin, ushqimin apo investimet. Lexuesit besojnë se pas tyre qëndron një ekspert, ndërsa në realitet marrin informacione të pasakta ose madje të rrezikshme. Në disa raste është zbuluar se të gjithë "autorët" janë të trilluar, me fotografi dhe biografi që po ashtu i gjeneron IA.



Si ta njohim influencerin e rrejshëm të IA-së? Edhe pse duken bindës, ekzistojnë shenja paralajmëruese. Fotot janë shpesh tepër të përsosura, pa asnjë të metë, me detaje të çuditshme në sfond. Postimet janë të përgjithshme, pa përvoja personale. Komentet duken si përgjigje të automatuara. Po ashtu, mungesa e videove të drejtpërdrejta ose e ndërveprimeve spontane mund të jetë shenjë se profili nuk është i vërtetë. Më e rëndësishmja: mos besoni verbërisht. Verifikoni burimet, mos klikoni në linqe të dyshimta dhe mos ndani të dhëna personale me profile që nuk mund t'i konfirmoni.

Dituria digjitale si mbrojtje Në epokën e inteligjencës artificiale, kufiri mes reales dhe virtuale po bëhet gjithnjë e më i hollë. Influencerët e IA-së mund të jenë interesantë dhe të dobishëm, por vetëm nëse janë transparentë. Problemi lind kur përdoren për manipulim, mashtrim dhe përfitim në kurriz të të tjerëve. Prandaj është e rëndësishme të zhvillojmë diturinë digjitale, të bëjmë pyetje, të analizojmë përmbajtjen dhe të mos e marrim çdo gjë si të mirëqenë. Sepse në një botë ku edhe fytyra mund të jetë e rreme, mbrojtja e vetme e vërtetë është mendimi kritik!



FAKE AI INFLUENCERS: VIRTUAL STARS THAT SELL ILLUSION

When the profile isn't real, but the influence is, welcome to the era of digital deception

In a world where social networks shape trends, lifestyles, and even our shopping decisions, a new type of "star" has emerged – those are AI influencers. At first glance, they seem perfect: always smiling, flawless in appearance, with carefully thought-out posts. Yet behind these accounts, there often isn't a real person, but an algorithm. The problem begins when that line blurs and the audience doesn't realize it's all an illusion.

AI influencers aren't necessarily a bad thing. Some are clearly labelled as virtual characters and used in marketing as creative tools. But more and more profiles present themselves as real people, without any warning that they're AI-generated. That's where the trouble starts. One of the most common scams involves fake product recommendations. An AI influencer "tests" cosmetics, clothing, or supplements and posts glowing reviews. Followers believe them, make purchases, and the product often doesn't match the description – or doesn't exist at all. In some cases, links lead to fraudulent websites that collect personal data or money without delivering the products.

Love, trust and then fraud

An even more dangerous trend is emotional manipulation. There have been cases where AI profiles engaged in direct communication with followers, building trust. Messages were personalized, warm, sometimes even romantic. People, unaware they were talking to an algorithm, developed feelings of closeness. In some cases, this led to financial scams: the "influencer" asked for help with an illness, a trip, or an investment. Followers sent money, and then the profile disappeared. These scams especially affect younger users and those seeking attention or support online.

Fake identities and stolen faces

One of the most disturbing abuses of AI is the use of real people's photos, modified into "new identities." These profiles look authentic because they use real elements, but they're essentially fake. Instead of foreign expression, here we can speak about "fake videos and images" that convincingly mimic someone's appearance and speech. There have even been cases where public figures' identities were misused in such deepfakes. Their "faces" promoted shady investments, cryptocurrencies, or even medical products. People believed it because they "saw" a familiar face – but the messages weren't theirs.

When AI writes – and deceives

The misuse of artificial intelligence doesn't stop at social media. Examples of so-called "AI writers" publishing books on the Internet

are becoming more and more common. On self-publishing platforms, hundreds of titles appear, fully generated by AI, but presented as the work of real authors.

The problem arises when such books are sold as professional or educational – for example, guides on health, nutrition, or investing. Readers believe an expert is behind them, but instead they receive inaccurate or even dangerous information. In some cases, it was discovered that complete "authors" were fabricated, with photos and biographies also generated by AI.

How to spot a fake AI influencer?

Even if they look convincing, there are warning signs. Photos are often too perfect, without imperfections, with odd details in the background. Posts are generic, lacking personal experiences. Comments may sound as automated replies. Also, the absence of live video content or spontaneous interactions can signal that the profile isn't real. Most importantly, don't trust blindly. Check sources, do not click suspicious links, and never share personal information with accounts you can't verify.

Digital literacy as protection

In the age of artificial intelligence, the line between real and virtual is thinner than ever. AI influencers can be interesting and useful – but only if they're transparent. The problem begins when they're used for manipulation, deception, and profit at someone else's expense. That's why it's crucial to develop digital literacy: to ask questions, analyse content, and don't take everything at face value. Because in a world where even a face can be fake, the only true protection is critical thinking!

Mendimi juaj për destinacionet verore?



ARIETA SHLIVOVA



Nëse do të mund të largoheshe diku këtë verë vetëm për 48 orë, ku do të shkoje dhe çfarë do të bëje fillimisht?

Do të zgjidhja Romën, sepse është një vend që ka gjithçka, histori, vibe dhe jetë. Edhe për 48 orë mund të përjetosh shumë. Fillimisht do të shkoja te Koloseu, pastaj do të shëtisja nëpër rrugicat e qytetit me një akullorë në dorë dhe do të ndalesha për foto në çdo cep interesant.

Çfarë e bën një destinacion veror të paharrueshëm për ty, njerëzit, atmosfera apo aktivitetet?

Për mua, një destinacion bëhet i paharrueshëm kur ka histori interesante, vende të bukura për t'u vizituar, njerëz mikpritës dhe një atmosferë të gjallë.

Do të preferojë të zbulosh një vend të fshehtë lokal apo të udhëtoje jashtë në një destinacion të famshëm këtë verë? Pse?

Do të preferoja të zbuloja një vend të fshehtë lokal, sepse zakonisht këto vende janë më të qeta, më pak të mbushura me turistë dhe kanë një bukuri natyrore. Gjithashtu është më interesante të zbulosh diçka që jo shumë njerëz e njohin.

If you could travel somewhere this summer for only 48 hours, where would you go and what would you do first?

I would choose Rome because it has everything, history, vibe, and life. Even in 48 hours, you can experience a lot. First, I would visit the Colosseum, then walk through the city streets with an ice cream in my hand and stop for photos at every interesting corner.

What makes a summer destination unforgettable for you, people, atmosphere, or activities?

For me, a destination becomes unforgettable when it has interesting history, beautiful places to visit, welcoming people, and a lively atmosphere.

Would you prefer to discover a hidden local place or travel abroad to a famous destination this summer? Why?

I would prefer to discover a hidden local place because these places are usually quieter, less crowded with tourists, and have natural beauty. It is also more interesting to discover something that not many people know.



DIART BERISHA



Nëse do të mund të largoheshe diku këtë verë vetëm për 48 orë, ku do të shkoje dhe çfarë do të bëje fillimisht?

Do të shkoja në Los Angeles, Kaliforni, sepse është një nga vendet e mia të preferuara dhe ka shumë aventura. Fillimisht do të shkoja në plazhet e bukura për të luajtur voleyboll dhe aktivitete të tjera. Në mbrëmje do të shëtisja qytetin ose do të shkoja në ndonjë festë.

Çfarë e bën një destinacion veror të paharrueshëm për ty, njerëzit, atmosfera apo aktivitetet?

Për mua janë aktivitetet. Nëse ke gjëra për të bërë gjatë gjithë ditës, si noti, eksplorimi apo aventura të vogla, nuk mërzitesh kurrë. Aktivitetet e bëjnë pushimin më dinamik dhe më të mbushur me kujtime.

Do të preferojë të zbulosh një vend të fshehtë lokal apo të udhëtoje jashtë në një destinacion të famshëm këtë verë? Pse?

Do të zgjidhja një vend të fshehtë lokal, sepse destinacionet e famshme nuk janë gjithmonë të arritshme. Një vend lokal është më praktik dhe më i përshtatshëm për të shkuar me shoqëri.

If you could travel somewhere this summer for only 48 hours, where would you go and what would you do first?

I would go to Los Angeles, California, because it is one of my favorite places and it has a lot of adventure. First, I would go to the beach to play volleyball and do other activities. In the evening, I would walk around the city or go to a party.

What makes a summer destination unforgettable for you, people, atmosphere, or activities?

For me, it is the activities. If you have things to do all day, like swimming, exploring, or small adventures, you never get bored. Activities make the holiday more dynamic and fuller of memories.

Would you prefer to discover a hidden local place or travel abroad to a famous destination this summer? Why?

I would choose a hidden local place because famous destinations are not always easy to reach. A local place is more practical and better for going with friends.

Ju lutemi na dërgoni mendimet tuaja për destinacionet verore në këtë email: magineforyou2003@gmail.com

Your opinion on summer destinations?



VERONA ZOGAJ



Nëse do të mund të largoheshe diku këtë verë vetëm për 48 orë, ku do të shkoje dhe çfarë do të bëje fillimisht?

Këtë verë do të doja të shkoja në Paris. Fillimisht do të vizitoja Kullën Eiffel, sepse është simboli më i njohur i qytetit dhe ka një pamje shumë të bukur. Pastaj do të shëtisja pranë lumit Seine dhe do të ulesha në ndonjë kafene për të shijuar atmosferën. Gjithashtu do të vizitoja edhe muzeun Louvre.

Çfarë e bën një destinacion veror të paharrueshëm për ty, njerëzit, atmosfera apo aktivitetet?

Për mua, një destinacion bëhet i paharrueshëm nga njerëzit dhe aktivitetet. Njerëzit mikpritës e bëjnë udhëtimin më të këndshëm, ndërsa aktivitetet si shëtitjet dhe vizitat e bëjnë përvojën më interesante.

Do të preferojë të zbulosh një vend të fshehtë lokal apo të udhëtoje jashtë në një destinacion të famshëm këtë verë? Pse?

Do të zgjidhja një destinacion të famshëm, sepse dua ta përjetoj vetë atë që shoh në rrjetet sociale dhe filma. Është ndryshe kur je aty dhe krijon përvojën tënde.

If you could travel somewhere this summer for only 48 hours, where would you go and what would you do first?

This summer I would like to go to Paris. First, I would visit the Eiffel Tower because it is the most famous symbol of the city and has a very beautiful view. Then I would walk near the Seine River and sit in a café to enjoy the atmosphere. I would also visit the Louvre Museum.

What makes a summer destination unforgettable for you, people, atmosphere, or activities?

For me, a destination becomes unforgettable because of the people and the activities. Friendly people make the trip more enjoyable, while activities like walking and visiting places make the experience more interesting.

Would you prefer to discover a hidden local place or travel abroad to a famous destination this summer? Why?

I would choose a famous destination because I want to experience in real life what I see on social media and in movies. It feels different when you are there and create your own experience.



ALBION MORINA



Nëse do të mund të largoheshe diku këtë verë vetëm për 48 orë, ku do të shkoje dhe çfarë do të bëje fillimisht?

Do të zgjidhja Sarandën, sepse është perfekte për një arratisje të shpejtë verore. Ka det të bukur dhe një atmosferë relaksuese. Fillimisht do të shkoja në plazh për një not të freskët, pastaj do të shëtisja buzë detit dhe do të shijoja një darkë me ushqim deti.

Çfarë e bën një destinacion veror të paharrueshëm për ty, njerëzit, atmosfera apo aktivitetet?

Për mua, bregdeti është vendi ideal. Ka pamje të bukura, ajër të pastër dhe shumë mundësi për aktivitete si noti, shëtitjet dhe sportet në ujë. Atmosfera është shumë pozitive dhe të bën të ndihesh i lirë dhe i qetë.

Do të preferojë të zbulosh një vend të fshehtë lokal apo të udhëtoje jashtë në një destinacion të famshëm këtë verë? Pse?

Do të preferoja të udhëtoja jashtë për të parë kultura të tjera dhe për të krijuar përvoja të reja. Udhëtimi jashtë vendit të zgjeron mendjen dhe të jep kujtime të veçanta.

If you could travel somewhere this summer for only 48 hours, where would you go and what would you do first?

I would choose Sarandë because it is perfect for a short summer escape. It has a beautiful sea and a relaxing atmosphere. First, I would go to the beach for a swim, then walk by the sea in the evening and enjoy a seafood dinner.

What makes a summer destination unforgettable for you, people, atmosphere, or activities?

For me, the seaside is the ideal place. It has beautiful views, fresh air, and many activities like swimming, walking, and water sports. The atmosphere is very positive and makes you feel free and relaxed.

Would you prefer to discover a hidden local place or travel abroad to a famous destination this summer? Why?

I would prefer to travel abroad to see different cultures and create new experiences. Traveling outside the country opens your mind and gives you special memories.

Please send us your thoughts on summer destinations on this email: magazineforyou2003@gmail.com

UDHËZUESI I FESTAVE TË VERËS: ARGËTIMI + MENÇURIA = KOMBINIMI MË I MIRË

Sezoni i festave të verës është duke u afruar, netë të gjata të ngrohta, muzikë në natyrë, jashtë me shoqëri deri vonë në mbrëmje dhe ajo ndjesia e veçantë e të qenit të lirë. Gjithçka duket e shkujdesur dhe e përsosur dhe mu për këtë me lehtësi relaksoheni më shumë seç duhet. Për këtë arsye është e rëndësishme të dini një gjë, festa më e mirë nuk është ajo ku ishit më të çmendur, por ajo nga e cila ktheheni në shtëpi të sigurt, të buzëqeshur dhe plot me histori që do t'i ritregoni për një kohë të gjatë.



Një plan i mirë është gjysma e betejës

Mund të tingëllojë si bezdi, por më besoni, planifikimi i mirë mund t'ju shpëtojë mbrëmjen. Para se të dilni, shikoni se ku po shkoni dhe kush po e organizon festën. Nuk është e njëjta gjë nëse është një festë në shtëpi të dikush që njihni apo në një vend ku nuk e njihni pothuajse askënd. Shkoni së bashku dhe kthehuni së bashku, ky

është një rregull që ka vërtet kuptim. Bini dakord paraprakisht se si do të ktheheni në shtëpi dhe kush rrin me kë. Sigurohuni që telefoni juaj të jetë i karikuar dhe nuk është keq nëse njëri nga prindërit ose njerëzit tuaj të afërt ta dinë se ku ndodheni. Nuk është çështje kontrolli, por sigurie.

Kujdes se çfarë pini - seriozisht!!!
Kjo nuk është vetëm këshillë, ky është

rregulli numër një. Mos pini pije nga të huaj dhe mos pini asgjë që nuk e keni marrë vetë ose nuk e keni parë se si bëhet. Nëse e lini gotën diku, mos e pini sërish të njëjtën. Ne e dimë që presioni shoqëror mund të jetë i fortë. "Hajde, vetëm një pije", "nuk do të të ndodhë asgjë"... por ju keni të drejtë të thoni JO, e madje edhe pa dhënë ndonjë shpjegim! Nëse nuk ju pëlqen diçka, nuk keni pse të merrni pjesë. Nuk është dobësi, është mençuri.



Qëndroni pranë grupit tuaj

Pjesa më e mirë e festës është shoqëria juaj, mos e harroni këtë. Të takosh njerëz të rinj mund të jetë interesante, por siguria juaj është tek njerëzit që u besoni. Pranoni të kontrolloni herë pas here, një mesazh "ku je?", ose një takim i shkurtër mund të thotë shumë. Nëse shihni se dikush nga grupi juaj nuk ndihet mirë ose është në një situatë të pakëndshme, mos e ktheni kokën. Miqtë e tregojnë vetën në ato momente (shoku i mirë në ditë të vështirë).

Dëgjoni veten - intuata juaj rrallë ju mashtron

Nëse diçka duket e çuditshme, e

pakëndshme ose "jo kjo s'është ashtu", ndoshta keni të drejtë. Nuk keni pse të qëndroni diku vetëm pse të gjithë janë atje. Ndihuni të lirë të distancoheni, të dilni jashtë ose thjesht të shkoni në shtëpi. Mos harroni, nuk keni pse të bëni gjithçka që e bëjnë të tjerët. Kufijtë tuaj janë të rëndësishëm. Qoftë pirja, sjellja apo shoqëria, ju zgjidhni atë që ju pëlqen!

Kthimi në shtëpi është pjesë e planit

Kur festa fillon të qetësohet, atëherë fillon pjesa më e rëndësishme, kthimi i sigurt. Mos udhëtoni vetëm, veçanërisht natën. Nëse merrni një taksi, kontrolloni. Edhe më mirë, ndani udhëtimin me dikë nga grupi. Nëse e shihni se situata në festë po ndryshon, turma, debate, atmosferë e pakëndshme, mos ngurroni të largoheni më herët. Nuk ka arsye të qëndroni aty ku më nuk ndiheni të sigurt.



Nuk është kontradiktore të argëtoheni dhe të jeni të përgjegjshëm në të njëjtën kohë! Kur e dini se jeni të sigurt, në të vërtetë relaksoheni dhe kënaqeni edhe më shumë. Festat janë për të krijuar kujtime, për të takuar njerëz, për të kaluar mirë dhe për të qeshur me lotë. Por, gjëja e vërtetë është t'i bëni të gjitha me zgjuarsë. Dhe kështu, herën tjetër që shkoni në një festë, mbani mend, qëllimi nuk është të jeni më i çmenduri në dhomë, por të jeni më i zgjuari në vendimin për të mbrojtur veten dhe shoqërinë tuaj!

SUMMER PARTY GUIDE: FUN + SMART = THE BEST COMBINATION

The summer party season is here, long warm nights, open-air music, hanging out until late, and that special feeling of freedom. Everything seems carefree and perfect, which makes it easy to relax more than you should. That's why it's important to remember one thing: the best party isn't the one where you were the wildest, but the one where you safely make it home, smiling and full of stories you'll retell for a long time.

A good plan is half the fun

It might sound boring, but trust me, good preparation can save your night. Before you go out, find out where you're going and who's organizing the party. It's not the same if it's a house party at someone you know versus a place where you barely know anyone. Go together and return together, that rule really makes sense. Decide in advance how you'll get home and who's sticking with whom. Make sure your phone is charged, and it's not a bad idea for a parent or someone close to know where you are. It's not about control, it's about safety.

Watch what you drink - seriously!!!

This isn't just advice, it's rule number one. Don't accept drinks from strangers and don't drink anything you didn't take yourself or see being made. If you leave your glass somewhere, don't go back to it. We know peer pressure can be strong: "Come on, just one," "It won't hurt you" ... but you have the right to say NO. And you don't need to explain yourself! If something doesn't feel right, you don't have to join in. That's not weakness, that's smart.

Stick with your crew

The best part of the party is your friends - don't forget that. Meeting new people can be fun, but your safety lies with those you trust. Agree to check in with each other from time to time, just a quick "where are you?" message or a short meet-up can mean a lot. If you see someone from your group feeling unwell or in an uncomfortable situation, don't look away. That's when true friends show up.

Listen to yourself - your gut rarely lies

If something feels strange, uncomfortable, or "off," you're probably right. You don't have to stay somewhere just because everyone else is there. Freely step outside, leave, or simply head home. And remember, you don't have to do everything others are doing. Your personal boundaries matter. Whether it's about drinking, behavior, or company, it is you who choose what feels right for you!

Getting home is part of the plan

When the party winds down, that's when the most important part begins: getting home safely. Don't go alone, especially at night. If you're taking a taxi, make sure it's a reliable one. Even better, share the ride with someone from your group. If you notice the atmosphere changing, such as crowds, arguments, tension, then feel free to leave early. There's no reason to stay somewhere you no longer feel safe.

It's not contradictory to have fun and be responsible at the same time! When you know you're safe, you can actually relax and enjoy yourself even more. Parties are about making memories, meeting people, having a great time, and laughing until your stomach hurts. But the real win is doing all that wisely. So next time you head to a party, remember: the point isn't to be the wildest in the room, but the smartest in choosing to protect yourself and your friends!

A PO MENDON TI APO IA?

IA-ja (Inteligjenca Artificiale) tani mund të shkruajë tekste, të krijojë muzikë, të zgjidhë detyra dhe të gjenerojë ide brenda pak sekondash. Ajo që sot duket si një mjet i dobishëm, po shndërrohet shpejt në diçka shumë më të madhe. Në të ardhmen e afërt, IA do të jetë pjesë e pothuajse çdo gjëje që bën, nga detyrat e shkollës deri te puna krijuese. Kjo e ngre një pyetje të rëndësishme: A po e përdor IA-në për të menduar më mirë, apo po e le ngadalë të mendojë në vendin tënd?

! Kur IA-ja bëhet përgjigja jote e parë

Po bëhet gjithnjë e më normale t'i drejtohesh IA-së për zgjidhje të shpejta. Në vend që ta mendojnë një problem deri në fund, shumë njerëz kalojnë menjëherë te një përgjigje e gatshme. Kjo kursen kohë, por mund të dobësojë aftësinë tënde për të zgjidhur probleme vetë. Në të ardhmen, ata që mbështeten shumë te IA-ja mund ta kenë më të vështirë të mendojnë në mënyrë të pavarur.

! Kur idetë nuk janë më plotësisht të tuat


IA-ja mund të gjenerojë ese, përshkrime dhe madje projekte të plota. Kjo mund të jetë e dobishme, por krijon edhe rrezik. Nëse IA-ja e bën pjesën më të madhe të punës, zëri yt fillon të humbasë. Me kalimin e kohës, mund të bëhet më e vështirë të dallosh se çfarë është origjinale dhe çfarë është e gjeneruar.

! Kur kreativiteti ndryshon

IA-ja tashmë po krijon muzikë, imazhe dhe video. Në të ardhmen, krijimi i përmbajtjes do të jetë më i lehtë se kurrë më parë. Sfida nuk do të jetë të krijosh diçka, por të krijosh diçka që ndihet reale dhe ndryshe. Kreativiteti do të ketë më shumë vlerë, jo më pak.

! Kur të menduarit bëhet një aftësi që duhet ta mbrosh

IA-ja do të vazhdojë të përmirësohet, por nuk do ta zëvendësojë nevojën për mendimin njerëzor. Aftësia për të pyetur, për të kuptuar dhe për të formuar mendimin tënd do të bëhet edhe më e vlefshme. Në vend që t'i kërkojsh IA-së përgjigje të gatshme, aftësia e vërtetë do të jetë të dish çfarë të pyesësh dhe pse.



💡 Mbaje mend:

IA-ja është këtu për të qëndruar dhe do të ndikojë në mënyrën se si mëson, krijon dhe mendon. E ardhmja nuk do të varet nga sa shpesh e përdor IA-në, por nga sa mirë arrin të mbash kontrollin mbi idetë e tua.

ARE YOU THINKING OR IS AI?

AI can now write texts, create music, solve homework, and generate ideas in seconds. What feels like a helpful tool today is quickly becoming something much bigger. In the near future, AI will be part of almost everything you do, from school tasks to creative work. This raises an important question: Are you using AI to think better, or are you slowly letting it think instead of you?

! When AI becomes your first answer

It is becoming normal to ask AI for quick solutions. Instead of thinking through a problem, many people go straight to a ready-made answer. This saves time, but it can also weaken your ability to solve problems on your own. In the future, those who rely too much on AI may find it harder to think independently.

! When ideas are no longer fully yours

AI can generate essays, captions, and even full projects. This can be useful, but it also creates a risk. If AI does most of the work, your own voice starts to disappear. Over time, it may become harder to tell what is original and what is generated.

! When creativity changes

AI is already creating music, images, and videos. In the future, creating content will be easier than ever. The challenge will not be making something but making something that feels real and different. Creativity will matter more, not less.

! When thinking becomes a skill you must protect

AI will continue to improve, but it will not replace the need for human thinking. The ability to question, understand, and form your own opinion will become more valuable. Instead of asking AI for answers, the real skill will be knowing what to ask and why.



💡 Remember:

AI is here to stay, and it will shape the way you learn, create, and think. The future will not depend on how often you use AI, but on how well you stay in control of your own ideas.

FJALËKRYQ SKANDINAV



Did
you
know?

"Çdo gjë e mirë, çdo gjë magjike ndodh
midis muajve qershor dhe gusht."

Jenny Han